

Teuta SHALA - PELI

KRIMET E FORCAVE SERBE NË KOMUNËN E PEJËS DHE TË ISTOGUT (1998-1999)

Në fund të shekullit XX populli shqiptar i Kosovës u përballë me dhunën gjenocidiale të ushtruar nga Serbia, si në aspektin ekonomik, social, politik, arsimor e kulturor. Dhuna serbe në Kosovë në të gjitha fushat e jetës, mori përmasa më të theksuara gjenocidiale, sidomos gjatë vitit 1998 dhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 1999, u zhvesh nga të gjitha normat më elementare njerëzore dhe mori dimensionin e hapur shfarosës kundër shqiptarëve.¹

Gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, pjesa më e madhe e popullsisë civile shqiptare në komunën e Pejës u vra në shtëpitë e tyre apo në shtëpitë ku ata ishin të strehuar. Madje, kishte raste kur forcat serbe i gruponin popullsinë civile shqiptare dhe grupe-grupe i dërgonin në shtëpi apo vende të ndryshme ku ata i shihnin si më të përshtatshme për të kryer krimin, e mandej për të zhdukur gjurmët e krimit në shumë raste iu vënin zjarrin kufomave, ose i zhvendosnin kufomat nga vendi ku e kryen krimin duke i dërguar në drejtime të panjohura për familjarët e të vrarëve, ku edhe sot më shumë se dy dekada pas përfundimit të luftës shumë persona akoma figurojnë në listën e të pagjeturve.

Gjithashtu ka raste kur forcat serbe nga kolona e të dëbuarve ndalonin civilët shqiptarë të cilët më pas i vrisnin. Që nga fillimi i luftës në Kosovë, edhe popullsia civile shqiptare e komunës së Pejës filloi që të përballej më dhunën e shtuar të forcave serbe. Po ashtu në forma të ndryshme filluan që ta kundërshtojnë dhunën dhe krimet që forcat serbe kryenin jo vetëm në komunën e Pejës, por edhe në nivel të Kosovës. Në përkrahje dhe mbështetje së popullsisë civile shqiptare, e cila që nga fillimi i luftës po vritej dhe po maltretohej në forma të ndryshme, edhe në komunën e Pejës u organizuan protesta paqësore, për të kundërshtuar dhunën që Serbia ushtronte ndaj popullit shqiptar të Kosovës.

¹ Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, *Buletini*, tetor-dhjetor 1999, Viti IX, nr. 13, 7. (më tej: KMDLNJ- *Buletini*, tetor-dhjetor 1999).

Më 18 mars të vitit 1998, në protestën gjithëpopullore të organizuar në Pejë, forcat serbe ushtruan dhunë duke i rrahur, plagosur si dhe vrarë protestuesit.² Në qytetin e Pejës, protesta të ngjashme gjithëpopullore, duke kundërshtuar dhunën e ushtruar nga forcat serbe ndaj civilëve shqiptarë, u organizuan edhe gjatë muajit prill. Edhe kësaj radhe forcat serbe intervenojnë kundër protestuesve ku keqtrajtojnë fizikisht si dhe burgosin disa persona, në mesin e të cilëve edhe disa nxënës.³ Si pasojë e protestës, keqtrajtime të tilla vazhduan edhe më 18 dhe 21⁴ prill të vitit 1998. Në fillim të luftës, forcat serbe në komunën e Pejës ushtruan më shumë dhunë fizike ndaj popullsisë civile, ndërsa numri i vrasjeve ishte më i vogël në krahasim me muajt në vijim.⁵

Me fillimin e ofensivave të forcave serbe kundër disa fshatrave të komunës së Pejës, filloi edhe vrasja e civilëve shqiptarë, ku në të shumtën e rasteve vrasjet kryheshin në masë. Vetëm më 25 maj të vitit 1998, forcat policore e ushtarake serbe pasi sulmuan dhe granatuan fshatin Lybeniq, depërtuan në fshat, më ç'rast nëpër shtëpitë e tyre vrasin dhe masakrojnë 9 civilë shqiptarë, si dhe plagosin disa të tjerë.⁶ Ndërsa në ofensivën e forcave serbe kundër fshatrave të Lugut të Baranit, më 29 maj 1998 në fshatin Vranoc janë vrarë katër civilë shqiptarë.⁷ Gjatë muajit në fjalë, forcat serbe

² Në këtë protestë nga forcat serbe u vra Qerim Muriqi (52) nga Fusha e Pejës. *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës mars-qershor 1999*, KMDLNJ, Pejë 2002, 114. (më tej: *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*); Fondi për të Drejtën Humanitare, Libër kujtimi i Kosovës 1998-2000, Prishtinë 2011, 258. (më tej: *Libër kujtimi i Kosovës*); Josef Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë? 1998-1999, Një dokumentim, 2013, 185. (më tej: *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*).

³ Odbor za zaštitu ljudskih prava i sloboda-Priština, *Bilten, april-jun, 1998*, Godina VIII, br.7, 88. (më tej: *OZLJPS- Bilten, april-jun, 1998*)

⁴ Po aty, 101.

⁵ Gjatë muajit prill 1998 në komunën e Pejës, nga forcat serbe më 24 prill në fshatin Kliqinë është vrarë Qelë Desku (41). *OZLJPS- Bilten, april-jun, 1998*, 104; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 114; Fetnete Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë. Pa apologji. Me fakte kundër shpifjeve*, Fokusi, Prishtinë, 2005, 106. (më tej: Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë*); Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë, 1998-1999*, Libri 1, Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës, Prishtinë 2010, 65. (më tej: Osmani, *Krimet e Serbisë 1*); Libër kujtimi i Kosovës, 258; Martinsen, *Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 279.

⁶ Më 25 maj të vitit 1998, nga forcat policore e ushtarake serbe, në fshatin Lybeniq u vranë këta persona: Bashkim Hamzaj (23), Rifat Hamzaj (24), Gani Hamzaj (25), Hysen Alimehaj (40), Dervish Hamzaj (51), Zeqë Hamzaj (53), Imer Hamzaj (53) dhe Brahim Hamzaj (64), të gjithë nga fshati Lybeniq, si dhe Haxhi Gogaj (22) nga Deçani. *OZLJPS- Bilten, april-jun, 1998*, 176; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 41; Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë*, 30; Osmani, *Krimet e Serbisë 1*, 67; Libër kujtimi i Kosovës, 261; Martinsen, *Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 187.

⁷ Më 29 maj të vitit 1998, gjatë ofensivës së forcave serbe ndaj fshatit Vranoc vriten këta persona: Beqir Krasniqi (49), Imer Ukaj (50), Fazë Krasniqi (43), Halil Krasniqi (50).

në aksione të shpërndara, në qytetin e Pejës dhe në fshatra të komunës së Pejës vranë edhe disa civilë, shumica prej të cilëve janë vrarë në shtëpitë e tyre.⁸

Pas këtyre ofensivave të forcave serbe, gjendja në komunën e Pejës e në veçanti në qytet ishte mjaft e tendosur. Forcat serbe ishin të pranishme në çdo pjesë të qytetit, ku nuk munguan maltretimet dhe vrasjet e civilëve shqiptarë.⁹ Dhuna ndaj civilëve shqiptarë në qytetin e Pejës u përshkallëzua pas sulmit të forcave serbe ndaj fshatit Loxhë. Pas këtij sulmi, popullsia civile shqiptare e lagjeve të Pejës “Dardania I”, II dhe III, pothuajse çdo ditë u përballën më dhunë të vazhdueshme e sistematike të forcave serbe. Që nga dita e parë e sulmit ndaj fshatit Loxhë më 6 korrik 1998, forcat serbe si dhe civilë serbë të armatosur i detyruan banorët e lagjeve “Dardania I”, II dhe III që të largohen nga shtëpitë e tyre. Gjatë këtyre aksioneve të cilat vazhduan edhe më 7 dhe 8 korrik, këto forcat në bashkëpunim me civilë të armatosur serbë, maltretuan dhe burgosën shumë banorë të lagjeve “Dardania I”, II dhe III, si dhe plaçkitën shumë shtëpi.¹⁰ Bashkë më banorët e këtyre lagjeve,

OZLJPS- *Bilten*, april-jun, 1998, 188; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 114, Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë*, 81; Libër kujtimi i Kosovës, 262-263; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 188.

⁸ Gjatë muajit maj forcat policore e ushtarake serbe në komunën e Pejës vranë edhe këta persona: më 6 maj të vitit 1998 në fshatin Buqan është vrarë Rifat Shala (30). Më 12 maj në fshatin Leshan plagoset rënd e pastaj vdes Murat Berisha (71). Më 25 maj rreth mesnate është vrarë Sadri Komoni (65) në Pejë. Më 29 maj forcat serbe në fshatin Lybeniq kanë vrarë e më pas e kanë djegur kufomën e Mehmet Ukshinaj (73). Më 29 maj në fshatin Kryshefc është plagosur nga forcat serbe e më pas ka vdekur Zymer Berisha (64). Në fshatin Kryshefc në fund të muajit maj është vrarë Ekrem Binakaj (40). OZLJPS- *Bilten*, april-jun, 1998, 131, 144, 178; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 114; Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë*, 35, 88,89, 92, 104; Libër kujtimi i Kosovës, 260, 262, 263, 264.

⁹ OZLJPS- *Bilten*, april-jun, 1998, 208. Më 5 qershor në fshatin Lybeniq është vrarë Ramë Haradinaj (84). *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 114; Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë*, 35; Osmani, *Krimet e Serbisë* 1, 67; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 189.

¹⁰ Odbor za zaštitu ljudskih prava i sloboda-Prishtina, *Bilten*, juli-septembar, 1998, Godina VIII, br.8, 106, 108 (më tej: OZLJPS- *Bilten*, juli-septembar, 1998). Gjatë korrikut të vitit 1998 në territorin e komunës së Pejës, forcat serbe kanë vrarë këta civilë shqiptarë: më 5 korrik 1998 në fshatin Lybeniq është vrarë Dërvish Aliqkaj (78), më 6 korrik, në lagjen “Dardania I” në Pejë është vrarë Nazmije Hoti (70). Po në këtë ditë, në mes të dy punkteve policore, në rrugën Loxhë-Pejë, është vrarë Vedat Komoni (33), nga lagja “Dardania III”. Më 7 korrik në Pejë janë vrarë Ali Panxhaj (54) dhe Malush Meha (49), kurse më 16 korrik është vrarë Astrit Musaj (25) Më 24 korrik 1998 në Pejë janë vrarë vëllezërit Bakir (32) dhe Adem Gjukaj (28) nga Peja, ndërsa Hajdin Vernezi (50) nga fshati Qyshk, është vrarë më 25 korrik në Loxhë. OZLJPS- *Bilten*, juli-septembar, 1998, 109, 116, 133, 134, 139; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 114, 115; Ramosaj, *Krimet serbe në*

forcat serbe dëbuan edhe rreth 6 000 civil shqiptarë, të cilët të ikur nga vatrat e luftës nga komuna e Deçanit ishin strehuar në këto lagje.¹¹ Më 3 gusht forcat serbe granatojnë fshatrat Gllogjan, Napolje dhe Llugagji. Më 15 dhe 16 gusht forca të shumta ushtarake policore serbe bombarduan me artileri të rëndë, tanke, avionë ushtarakë, fshatrat Loxhë, Raushiq dhe Grabovc, ndërsa më 24 gusht me tanke dhe artileri të rënda sulmuan fshatrat e Rugovës, Shtupeq i Madh dhe i Vogël.¹² Këto tri ofensiva të forcave serbe përgjatë gushtit të vitit 1998 ndaj fshatrave të komunës së Pejës, u shoqëruan edhe me vrasjen e popullsisë civile.¹³

Pas këtyre ofensivave, forcat serbe plaçkitën e më pas dogjën shtëpitë në lagjen “Dardania I”, II dhe III, si dhe fshatrat të cilat ishin cak i sulmeve gjatë atyre ofensivave.¹⁴ Përveç këtyre veprimeve, për më tepër forcat serbe u pozicionuan në postblloqe në drejtim të Rozhajës, Rugovës, Lugut të Baranit, Loxhës, duke bërë të pamundur çdo lëvizje në drejtim të atyre vendeve edhe ata persona që tentonin të kalonin përveçse i maltretonin madje edhe i arrestonin. Si pasojë e këtyre veprimeve më se keqi e pësuan fshatrat e Rugovës, të cilët për muaj të tërë mbeten në izolim të plotë, pa mundësi furnizimit me artikuj ushqimorë, barna e gjësende të tjera, as nga Peja e as nga Mali i Zi.¹⁵

Në fund të vitit 1998, në komunën e Pejës, e në veçanti në qytet vërehet një prani e madhe e forcave serbe, si dhe një mobilizim i madh i civilëve serbë. Në kuadër të këtij mobilizimi, në fillim të muajit nëntor forcave serbe në Pejë iu bashkuan edhe një numër i madh i policëve të cilët kishin ardhur nga Serbia.¹⁶ Në fund të dhjetorit, forcat ushtarako-policore serbe për disa ditë me radhë, prej 17 deri më 20 dhjetor 1998 rrethuan lagjet e Pejës: “Karragaq”, “Zatra”, “Kapeshticë”, “Jarina”, “Asllan Çeshme” dhe “Haxhi Zeka”, ku bastisën, keqtrajtuuan dhe arrestuan shumë banorë

Kosovë, 93, 105; Libër kujtimi i Kosovës, 265, 268, 270, 271; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 191, 195, 197.

¹¹ Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë*, 94.

¹² OZLJPS - *Bilten, juli-septembar, 1998*, 148, 165, 167, 179.

¹³ Më 15 gusht, gjatë sulmit të forcave serbe ndaj fshatit Loxhë u vra Cyme Shala (84). Më 16 gusht 1998 gjatë një aksioni të forcave serbe ndaj fshatit Dobërdol është vrarë Brahim Novaj (69), më 30 gusht në Turjakë është vrarë Ramë Krasniqi (60). Gjatë sulmeve të forcave serbe ndaj fshatrave të Rugovës më 24 gusht janë vrarë vëlla e motër Mustafë (60) dhe Dude (60) Lajçi nga Shtupeqi i Vogël. OZLJPS- *Bilten, juli-septembar, 1998*, 191; KMDLNJ - *Buletini, tetor-dhjetor 1998*, 156; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 115; Libër kujtimi i Kosovës, 274, 275; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 197, 198.

¹⁴ OZLJPS - *Bilten, juli-septembar, 1998*, 198, 230.

¹⁵ KMDLNJ- *Buletini, tetor-dhjetor 1998*, 135.

¹⁶ Po aty, 127, 148, 167, 168, 199.

shqiptarë.

Në disa nga këto lagje ishin të strehuar një numër i madh i të zhvendosurve nga vatrat e tjera të luftës.¹⁷ Një gjendje e tillë në komunën e Pejës mbizotëroi edhe në tremujorin e parë të vitit 1999. Në punktet policore në hyrje-daljet e qytetit vërehej përqendrim i madh i forcave policore serbe, të cilat keqtrajtonin kalimtarët, në qytet dhe në fshatrat përreth vëreheshin lëvizje të forcave serbe, si dhe nuk munguan as vrasjet e civilëve shqiptarë.¹⁸ Që nga fillimi i luftës në Kosovë, në komunën e Pejës dhe fshatrat e saj, sikurse edhe në pjesët e tjera të Kosovës, forcat serbe përdorën forma të ndryshme të dhunës ndaj popullsisë civile, duke i burgosur, vrarë dhe masakruar në mënyrën më barbare. Vrasjet në masë si dhe dhuna ndaj civilëve shqiptarë në Kosovë në përgjithësi është rritur sidomos gjatë ndërhyrjes së forcave të NATO-s mars-qershor të vitit 1999.

Për 78 ditë me radhë sa zgjatën bombardimet e NATO-s, forcat serbe në vazhdimësi kryen vrasje në masë, plaçkitën, dëbuan dhe maltretuan në forma të ndryshme popullsinë civile shqiptare si në lagjet e qytetit ashtu edhe në fshatrat të komunës së Pejës. Gjatë asaj kohe forcat policore e ushtarake serbe shpeshherë të shoqëruara edhe nga popullsia serbe vendase, vranë në masë popullsinë civile, qoftë gjatë dëbimit nga shtëpitë e tyre dhe deportimit për në Mal të Zi dhe Shqipëri, ashtu edhe atë pjesë të popullsisë e cila gjatë ndërhyrjes së forcave të NATO-s, mars-qershor 1999, kishin mbetur në Kosovë.

Dhuna e forcave serbe ndaj popullsisë civile në qytetin e Pejës u intensivua sidomos pas ndërhyrjes së NATO-s më 24 mars 1999. Një ditë pas kësaj, forcat serbe sulmojnë lagjet “Kapeshticë” dhe “Zatra”. Pas granatimit disaorësh të këtyre lagjeve, forcat serbe me një dhunë të pa parë fillojnë me dëbimin e banorëve nga lagjet e Pejës: “Zatra”, “Kapeshtica” dhe “Dardania I dhe II”, duke i deportuar për në Shqipëri dhe Mal të Zi. Përveç se i plaçkitën dhe i dogjën shtëpitë, aksioni i tyre për dëbimin e banorëve nga lagjet e Pejës u shoqërua edhe me vrasjen e popullsisë civile.

¹⁷ Në periudhën shtator-dhjetor 1998, në komunën e Pejës janë konfirmuar dy civilë të vrarë: Rexhep Kaliqani (55), nga Peja i vrarë më 20 shtator 1998 në Pejë dhe Nuredin Zejnullahu (49), po ashtu nga Peja i vrarë më 18 nëntor në Pejë. OZLJPS- *Bilten, juli-septembar, 1998*, 206; KMDLNJ- *Buletini, tetor-dhjetor 1998*, 225, 228, 232; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 115; Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë*, 107; Osmani, *Krimet e Serbisë* 1, 69; Libër kujtimi i Kosovës, 227; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 204.

¹⁸ Gjatë muajit janar të vitit 1999 në komunën e Pejës janë vrarë këta civilë: më 2 janar, në fshatin Gllaviçicë është gjetur i vrarë Veton Kelmendi (27) nga fshati Pavlan, ndërsa më 31 janar, në fshatin Ramun nga forcat policore serbe është vrarë Emin Basha (36) nga lagja “Sahat Kulla”. KMDLNJ- *Buletini, janar- mars 1999*, 46, 106; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 38, 63; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 206, 207.

Gjatë periudhës mars-qershor 1999, forcat serbe krimet më mizore i kryen në lagjet “Dardania I” dhe II, dhe “Fusha e Pejës”. Aksionet e armatosura të forcave serbe në lagjen “Dardania I” dhe II”, filluan më 27 mars 1999, kur forca të shumta ushtarake e policore serbe rrethuan lagjen, pastaj hynë me dhunë në shtëpitë e shqiptarëve të cilat i plaçkitën dhe i dogjën. Gjatë këtij aksioni, forcat serbe dëbuan banorët nga lagjja “Dardania I” e II, si dhe shumë prej tyre i vranë.¹⁹ Krimi më i rëndë në lagjen “Dardania” ndodhi më 12 qershor, kur pjesëtarë të forcave serbe në mbrëmje hynë në familjen Bala, pasi u morën para dhe stoli, vrasin 7 anëtarë të kësaj familjeje, në mesin e të cilëve 5 fëmijë të moshës 5-13 vjeç.²⁰

Forcat serbe kështu vepruan edhe ndaj banorëve të lagjes “Fusha e Pejës”, të cilët aksionet e tyre të armatosura i filluan më 26 mars të vitit 1999. Që nga data 26 mars e deri më 29 maj 1999, forcat serbe disa herë e sulmojnë këtë lagje, por katër aksione të tyre: ai i 26 dhe 29 marsit si dhe aksionet e 13 dhe 28 majit ishin me fatalitet. Gjatë aksionit të forcave serbe të datës 26 mars 1999 në “Fushë të Pejës”, i cili nuk zgjati më shumë se dy orë, u vranë 14 persona, e po ashtu në forma të ndryshme u maltretuan shumë të tjerë, të cilët përveçse u plaçkitën, u dëbuan me dhunë nga shtëpitë e tyre.²¹

¹⁹ Në sulmin e 27 marsit ndaj popullsisë civile në lagjen “Dardania I” e II u vranë këta civilë: Atdhe Ramosaj (17), Rexhep Smajli (17), Ahmet Smajli (19), Ahmet Lajçi (19), Bekim Aliçkaj (21), Afrim Buqaj (23), Arben Berbati (26), Blerim Shala (26), Bashkim Lokaj (27), Zija Aliçkaj (31), Arbnor Gega (31), Enver Gashi (32), Besnik Lokaj (32), Nevzat Kastrati (33), Xhelal Gega (37), Ismet Nikçi (37), Orfej Berisha (38), Shaqir Haxhijaj (40), Fadil Gashi (42), Besim Gjokolli (43), Milaim Hoxha (45), Ismet Berisha (45), Jusuf Kelmendi (47), Adem Kamberi (48), Ruzhdi Ramosaj (50), Ramadan Bekaj (51), Sadik Berisha (54), Muhamet Bytyqi (55), Ali Gashi (58), Gjyke Thaqi (59), Halit Beqiri (59), Malë Kelmendi (61), Ramë Aliçkaj (64), Bektesh Shalunoviq (65), Metë Gashi (67), Azem Gashi (68), Dinë Haxhijaj (72), Dinë Gashi (75), Ymer Gashi (78), Ymer Bërbati (92). Në lagjen “Dardania I” e II, më 28 mars u vra Rexhep Deçani (51). Më 17 dhe 18 prill janë vranë Fadil Bojaj (20) dhe Milazim Berisha (37), ndërsa më 9 maj janë vranë Marjan Dedaj (46) dhe Petrit Dedaj (31); *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 25-37; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 227, 228, 229, 230, 231, 234, 263, 301,

²⁰ Më 12 qershor, pjesëtarë të forcave serbe vranë këta anëtarë të familjes Bala: Nita Bala (5), Agon Bala (6), Rina Bala (7), Dardane Bala (12), Hajri Bala (13), Vjollca Bala (28), Musa Bala (31). KMDLNJ, Buletini, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Nën pushtetin e urdhrave. Krimet e luftës në Kosovë*, Human Rights Watch, Tiranë 2002, 323; (më tej: *Nën pushtetin e urdhrave*); *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 36-37; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 322.

²¹ Më 26 mars 1999, në lagjen “Fusha e Pejës”, nga forcat serbe u vranë këta persona: Haki Lajçi (20), Valdet Krasniqi (21), Skënder Alushaj (32), Eshref Krasniqi (50), Ramë Shabanaj (52), Nimon Shabanaj (53), Adem Lajçi (54), Bekë Shala (55), Mustafë Lajçi (56), Xhafer Alushaj (62), Haxhi Nikçi (65), Mehmet Bajraktari (65), Isuf Muriqi, (68), Fane

Më 29 mars të vitit 1999, forcat serbe ndërmarrin përsëri një aksion të armatosur ndaj banorëve të lagjes “Fusha e Pejës”. Forcat serbe përveç vrasjeve, dëbimit nga shtëpitë, si dhe djegieve të shtëpive, gjatë këtij sulmi, kishin plaçkitur banorët e lagjes duke u marrë para dhe stoli.²² Sulmet, vrasjet, plaçkitjet si dhe maltretimet e shumta të forcave serbe ndaj banorëve të lagjes “Fusha e Pejës” vazhduan edhe gjatë muajit maj të vitit 1999. Më 13 maj 1999, forcat serbe sulmojnë përsëri lagjen “Fusha e Pejës”, gjatë këtij aksioni, forcat serbe shumicën e kufomave i kanë djegur.²³ Një sulm tjetër i forcave serbe gjatë majit të vitit 1999 në lagjen “Fusha e Pejës” është edhe ai i datës 28 maj, në shënjestër të të cilit ishte familja Kastrati. Më 28 maj 1999, në orët e hershme të mëngjesit, forcat serbe kishin hyrë në oborrin e shtëpisë ku ishte e strehuar familja Kastrati, duke vrarë pesë meshkujt e familjes Kastrati si dhe pronarin e shtëpisë në të cilën ishte e strehuar ajo familje.²⁴ Në lagjen “Fusha e Pejës” në periudhën mars-qershor 1999 janë vrarë 42 civilë.²⁵ Në qytetin e Pejës forcat serbe gjatë muajve mars-qershor kryen krime edhe në lagjet e tjera të qytetit si: “Kapeshticë”²⁶,

Shabanaj (74). *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 19-21; Teuta Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës, mars-qershor 1999*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë 2019, 69-74 (më tej: Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*).

²² Më 29 mars 1999, në lagjen “Fusha e Pejës”, nga forcat serbe u vranë këta persona: Bashkim Berisha (32), Hilmi Zeqiri (34), Skënder Zeqiri (46) dhe Ukë Selimaj (73). *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 21-22; Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 75-76.

²³ Më 13 maj u vranë këta persona: Fatjana Marmellaku (2), Arben Qerkinaj (22), Zahide Qerkinaj (26), Adem Nikçi (28), Sali Gashi (30), Mehmet Nikçi (60), Nurie Qerkinaj (60), Ali Nikçi (65), Ramë Qerkinaj (68), Musli Zekaj (70), Shaban Nikçi (76), Smajl Beqiraj (77), Sadik Duraku (78). *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 23; Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 76-77.

²⁴ Më 28 maj forcat serbe vranë këta persona: Alban Kastrati (17), Adrian Kastrati (23), Valdet Kastrati (29), Hasan Muratagiq (39), Xhafer Kastrati (52) dhe Sokol Kastrati (56). *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 21-22; Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 78-86.

²⁵ Në lagjen Fusha e Pejës në periudhën mars-qershor 1999 janë vrarë edhe këta persona: më 27 mars është vrarë Qerim Nikçi (27), më 29 mars janë vrarë Mehmet Gashi (40) dhe Vehbi Hoxhaj (68), më 31 mars Adem Lajçi (35), ndërsa më 17 maj është vrarë Mon Gjonaj (64). Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, *Buletini, mars-shtator 1999*, Viti IX, nr. 11-12, 90. (më tej: *Buletini, mars-shtator 1999*); KMDLNJ-Pejë, Lista e të ekzaminuarve dhe të identifikuarve nga ekipi mjekësor i Tribunalit të Hagës dhe ekipit të KMDLNJ në Pejë filluar më 02.08.1999, Pejë, 19. 08.1999, 3; Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 86.

²⁶ Nga lagjja “Kapeshticë” gjatë muajve mars-qershor 1999 janë vrarë këta persona: më 26 mars Dinë Gjurkaj (45), më 29 mars Haxhi Idrizi (82), më 30 mars Hyrie Lekaj (65), më 7 prill Hasan Shkuliqi (57). Më 10 dhe 14 prill janë vrarë Bajram Sadriaj (71) dhe Haxhere Blakaj (70) në Bjeshkët e Jabllanicës së Madhe. Më 13 prill është vrarë Musa Rrahmani

“Zatra”²⁷, “Haxhi Zeka”²⁸, “Karragaq”²⁹, “7 Shtatori”³⁰ dhe “Dardania III”³¹, ku u vranë një numër mjaft i madh i civilëve.³²

Një nga krimet më të mëdha të kryera nga forcat serbe në komunën e Pejës ndodhi në fshatin Lybeniq. Më 1 prill të vitit 1999 në orët e hershme të mëngjesit forca të mëdha ushtarake, policore e paraushtarake serbe sulmuan fshatin Lybeniq. Gjatë këtij sulmi, i cili u shoqërua më të shtëna armësh, forcat serbe po ashtu i maltretonë banorët duke i rrahur, plaçkitur e duke i kërcënuar me vrasje, i detyrojnë që t’i lëshojnë shtëpitë e tyre dhe të tubohen në qendër të fshatit. Pas arritjes së banorëve në qendër të fshatit, forcat serbe filluan që t’i ndajnë nga turma rreth 80 persona, ndërsa pjesën tjetër kryesisht femra, fëmijë dhe të moshuar i detyrojnë që të largohen drejt Shqipërisë. Personat e ndaluar pas disa provokimeve dhe maltretimeve që u bëjnë, forcat policore e ushtarake serbe vrasin rreth 60 prej tyre, ndërsa pjesa tjetër mbesin të plagosur. Pas kryerjes së krimit, forcat serbe një pjesë të kufomave i zhvendosin nga vendi i krimit.³³

(80) në Vitimiricë, ndërsa më 26 prill është vranë Myrvete Berisha (73). Më 5 maj janë vranë Bajram Tigani (64) dhe Bahrie Tigani (50). Më 25 maj janë vranë Ramë Hajdaraj (67) dhe Sefedin Therra (74). Më 10 qershor janë vranë Jusuf Turjaka (73) dhe Remzie Turjaka (64). *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 38-39; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 222, 231, 234, 298, 321.

²⁷ Nga kjo lagje më 26 mars janë vranë Naje Dema (64) dhe Bali Gashi (63), më 28 mars është vranë Rizah Mamaj (61), ndërsa më 31 mars është vranë Elfete Osmanaj (21). *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 38; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 221, 222.

²⁸ Nga kjo lagje janë vranë këta persona: më 5 prill Remzi Hasani (71), dhe Çake Husaj (88), më 29 prill janë vranë bashkëshortët Muharrem Pasha (75) dhe Jakute Pasha (73), më 5 maj Gjylizare Shoshi (43), më 18 maj Ibish Çeku (42) dhe Ymer Shala (40), dhe më 11 qershor janë vranë Hasan Rexhepagiqi (72) dhe Naja Shariqi (74). *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 38-39; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 253.

²⁹ Nga kjo lagje, më 3 maj mbi fshatin Radavc është vranë Shyhrete Haxhihasani (52). *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 39; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 296.

³⁰ Nga lagja “7 Shtatori” janë vranë këta persona: më 27 mars Avdullah Vuçetaj (63), më 7 maj janë vranë Rrustem Ibraj (50) dhe Valbonë Ibraj (24). Më 22 maj në burgun e Dubravës është vranë Sahit Brahimaj (45).

³¹ Nga kjo lagje nga forcat serbe janë vranë: më 19 maj si pasojë e dhunës së ushtruar nga forcat serbe vdes Kamer Gashi (72), e po këtë ditë forcat serbe kanë vranë edhe Zenel Gashin (61), Bekë Komonin (72), Dinë Gashin (80) dhe Kadri Kastratin (82). *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 39.

³² Në periudhën mars-qershor 1999 në pjesë të ndryshme të qytetit janë vranë edhe këta persona: më 25 mars janë vranë Hysë Muriqi (35) dhe Namik Bilalli (29), më 27 mars Xhelal Brovina (28) dhe Aziz Nepopla (71). Më 4 maj në Pejë është vranë Nekibe Gashi (42). *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 18, 40, 117.

³³ Më 1 prill 1999, në fshatin Lybeniq forcat serbe vranë këta persona: Gëzim Avdullahaj (15), Fehim Huskaj (18), Tafil Huskaj (18), Gani Shoshi (23), Xhavit Hamzaj (24), Fazli

Në komunën e Pejës, në periudhën mars-qershor 1999, një krim tjetër me përmasa gjenocidiale ndaj civilëve shqiptarë ndodhi më 14 maj, në fshatrat Qyshk, Pavlan dhe Zahaq. Në orët e hershme të 14 majit të vitit 1999, forca të shumta serbe rrethuan fshatin Qyshk dhe hynë shtëpi më shtëpi, duke i detyruar banorët që t'i lëshojnë shtëpitë dhe të tubohen në qendër të fshatit. Pas këtij veprimi, forcat serbe urdhërojnë meshkujt të dalin në një rën anë, ndërsa gratë e fëmijët, në anën tjetër. Banorët e tubuar i kërcënojnë dhe detyrojnë që të dorëzojnë para, stoli apo gjësende të tjera me vlerë, ose në të kundërtën, do t'i vrisnin në qoftë se do t'u gjenin diçka në xhepa. Pas kësaj, forcat serbe, nga turma e tubuar, ndajnë 32 burra, ndërsa pjesën tjetër të turmës i detyrojnë që të niseshin në drejtim të qytetit të Pejës me qëllim që t'i deportonin për në Shqipëri. Ndërkaq, të 32 burrat e ndarë nga turma i ndajnë në tri grupe dhe i vendosin në tri dhoma, në tri shtëpi të ndryshme, duke përdorur pothuajse të njëjtën formë të dhunës. Ritualit ishte i njëjtë, që posa i fushin brenda dhe pas fyerjeve të shumta, mbi ta zbraznin breshëri plumbash dhe në fund kufomave ua vënin zjarrin. Në grupin e parë ishin 12 veta, ndërsa në grupin e dytë dhe të tretë ishin nga 10 veta. Më 14 maj në fshatin Qyshk, forcat serbe në pjesë të ndryshme të fshatit vranë edhe 9 civilë, duke arritur kështu numri i të vrarëve dhe të masakruarve në 41 veta. Për të humbur gjurmët e krimit shumicën e kufomave i kishin djegur, duke kryer një nga krimet më mizore ndaj popullsisë civile.³⁴ Më 14 maj

Ukshinaj (29), Ramiz Berisha (29), Rexhep Rexhaj (29), Çun Morina (30), Zeqë Bobi (30), Riza Morina (31), Ferdane Alimehaj (33), Qamil Ukshinaj (33), Osman Huskaj (34), Ruzhdi Ukshinaj (34), Ramë Avdullahaj (35), Bajram Bushati (37), Nazmi Rustemaj (37), Haxhi Huskaj (38), Muzli Haradinaj (40), Ramiz Hamzaj (41), Shaban L. Alimehaj (41), Hazir Alimehaj (42), Naim Huskaj (42), Ilir Lokaj (43), Ukë Bushati (47), Rustem Alimehaj (49), Hajdar Ukshinaj (51), Haxhi Alimehaj (52), Ramë Ukshinaj (52), Fadil Alimehaj (56), Avdyl Bobi (57), Nekë Huskaj (59), Adem Haradinaj (60), Sefer Shoshi (61), Smajl Bushati (62), Bajram Bobi (63), Ramë Huskaj (64), Bekë Bobi (65), Haradin Huskaj (65), Selim Hamzaj (65), Shaban J. Alimehaj (66), Adem Bushati (67), Bajram Alimehaj (68), Musa Jahmurataj (69), Metush Huskaj (72), Ali Shoshi (75) dhe Kadri Jahmurataj (87), të gjithë nga Lybeniqi. Në këtë grup janë të vrarë edhe disa persona nga komuna e Deçanit. *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 41-45; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 245, 247, 257.

³⁴ Në periudhën mars-qershor 1999, në fshatin Qyshk, forcat serbe kanë vrarë këta persona: më 25 mars Ramë Kelmendi (91), më 13 maj janë vrarë Aziz Sharapolli (72) dhe Nerxhivane Sharapolli (62), ndërsa më 14 maj janë vrarë: Erdogan Kelmendi (19), Arian Lushi (20), Mentor Kelmendi (23), Ismet Dinaj (32), Ahmet Gashi (35), Skënder Gashi (36), Besim Kelmendi (37), Haki Gashi (38), Hasan Avdylaj (39), Zeqir Alijaj (39), Brahim Kelmendi (40), Ramiz Lushi (40), Rasim Rama (40), Sefedin Lushi (40), Demë Kelmendi (41), Gani Avdyli (41), Selim Gashi (42), Xhafer Gashi (42), Skënder Lushi (44), Isuf Shala (45), Xhafer Lushi (46), Jashar Gashi (47), Osman Lushi (47), Skënder Kelmendi (47), Emrush Krasniqi (49), Sylë Gashi (49), Muhamet Shala (50), Qaush Lushi

1999, cak i sulmeve të forcave ushtarake-policore serbe, përveç fshatit Qyshk, ishte edhe fshati Pavlan. Menjëherë pas vrasjes dhe masakrimit të banorëve të fshatit Qyshk, si dhe plaçkitjes dhe djegies së shumë shtëpive, forcat serbe aksionin e tyre e vazhduan në drejtim të fshatit Pavlan, duke përdorur të njëjtën metodë të dhunës dhe të krimit. Për t’ju shmangur masakrimit, vrasjeve apo çfarëdo forme të dhunës, që forcat serbe përdorën atë ditë, shumë banorë i braktisën shtëpitë e tyre dhe u detyruan të largohen, duke kërkuar strehim më të sigurt. Duhet theksuar se forcat ushtarake-policore serbe më 14 maj 1999 në fshatin Pavlan, vranë dhe masakruan dhjetë civilë.³⁵

Forcat serbe pas fshatit Pavlan, aksionin e tyre e vazhduan në drejtim të fshatit Zahaq. Edhe këtu rrethuan fshatin, pastaj grupe më të vogla të armatosura e të uniformuara hynë shtëpi më shtëpi. Duke shtënë me breshëri armësh, i detyrojnë banorët që me nxitim të tubohen në qendër të fshatit. Pas grumbullimit të banorëve në qendër të fshatit, forcat serbe, fillimisht, kërkuan nga ata që t’i dorëzojnë paratë, stolitë dhe gjësendet e tjera me vlerë që i kishin. Përveç parave dhe stolive atyre ua marrin edhe dokumentet, si letërnjoftimet e pasaportat dhe pastaj, masën e tubuar e detyrojnë që me kamionë, traktorë apo me mjete të tjera që i dispononin, të niseshin në drejtim të Pejës. Me të arritur tek autoservisi “Kuçi”, forcat serbe e ndalin kolonën, nga e cila i marrin 19 meshkuj, ku pas ofendimeve dhe fyerjeve të shumta, filluan të shtinë mbi ta. Nga këto të shtëna, përveç një personi, të gjithë të tjerët vriten. Si pasojë e sulmeve të forcave serbe më 14 maj 1999, në fshatin Zahaq u vranë 22 persona në mesin e të cilëve kishte edhe të moshuar.³⁶ Më 14 majit 1999, në fshatrat Qyshk, Pavlan dhe

(50), Iber Kelmendi (52), Halil Gashi (55), Brahim Gashi (56), Ibish Gashi (56) Ukë Lushi (57), Avdullah Lushi (59), Brahim Gashi (60), Emin Gashi (60), Ramë Gashi (60), Musa Gashi (64), Avdi Berisha (65), Kadri Çeku (68), Hasan Çeku (69). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Nën pushtetin e urdhrave*, 330-341; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 59-62; Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 133-146.

³⁵ Më 14 maj në fshatin Pavlan janë vranë këta persona: Haxhi Dreshaj (41), Agim Selmanaj (47), Shaban Kelmendi (52), Brahim Nikçi (53), Nimon Gashi (53), Hatixhe Nikçi (55), Gjejlane Nikçi (57), Zenun Shala (58), Muçë Lulaj (64), Zymer Gashi (67). Në këtë fshat gjatë muajit qershor janë vranë këta persona: më 8 qershor janë vranë: Ajshe Kelmendi (44) dhe Ukshin Kelmendi (77), ndërsa më 10 qershor është vranë Halil Nikçi (29). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Nën pushtetin e urdhrave*, 343-344; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 63-64; Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 161-166.

³⁶ Në Zahaq më 14 maj janë vranë: Gëzim Cukaj (19), Bekim Delia (21), Demë Atashi (21), Hysen Gjoka (21), Fehmi Gjoka (23), Shaban Smajlaj (23), Bajrush Hyseni (24), Faton Rama (24), Zymer Smajlaj (26), Agim Hyseni (28), Halit Dobra (31), Hamëz Murati (31), Sabit Hyseni (31), Shpend Hyseni (31), Muhamet Dobra (33), Valdet Rama (36), Naim

Zahaq, forcat serbe vetëm brenda disa orëve, arritën të vrasin dhe të masakrojnë 73 persona të moshave të ndryshme dhe të të dy gjinive. Pas vrasjes së civilëve shqiptarë, pjesën më të madhe të kufomave i dogjën. Përveç këtij veprimi, forcat serbe në fshatin Zahaq, një pjesë të kufomave i larguan nga vendi i ngjarjes duke i dërguar në drejtime të panjohura për familjarët e të vrarëve.

Krimeve të forcave serbe, nuk u shpëtuan as fshatrat, Nakëll, Llabjan, Ramun, Leshan, dhe Kliçinë, edhe pse numri i vrasjeve të popullsisë civile shqiptare në këto fshatra ishte më i vogël në krahasim me vendet e përmendura më lart. Edhe fshati Nakëll, ishte në shënjestër të dhunës së ushtruar nga forcat serbe. Më 1 maj të vitit 1999 forcat serbe rreth orës 19 hynë në këtë fshat. Gjatë këtij aksioni forcat policore e ushtarake serbe i dëbuan me dhunë banorët nga shtëpitë e tyre, pastaj plaçkitën dhe i dogjën afro 20 shtëpi të këtij fshati. Forcat serbe në bashkëpunim me banorët serbë të fshatit Nakëll, më 12 maj të vitit 1999, rreth orës 11:00 hynë përsëri në fshatin Nakëll, ku gjatë këtij aksioni maltretuan, rrahën, plaçkitën, dëbuan banorët, si dhe vranë disa prej tyre.³⁷ Vrasjet, dëbimet, plaçkitjet si dhe format e tjera të dhunës së ushtruar nga forcat serbe i përjetuan edhe banorët e fshatit Llabjan. Më 1 maj të vitit 1999 rreth orës 22:00, forcat serbe e filluan aksionin e tyre ndaj popullsisë civile. Sulmet dhe njëkohësisht krimet e forcave serbe ndaj popullsisë civile në fshatin Llabjan vazhduan për tri ditë me radhë, më 1, 2 dhe 3 maj. Epilogu tragjik i vrasjeve në këtë fshat ndodhi gjatë muajit maj 1999, ku vriten gjithsej 16 persona, ndërsa disa prej kufomave akoma janë të pagjetura.³⁸ Edhe fshatrat

Hyseni (38), Ismet Hyseni (41), Shaban Neziri (41), Shaban Rama (45), Fazli Dobra (46), Sadri Rama (54), ndërsa më 16 maj është vrarë Zenel Neziri (66). Në këtë fshat më 10 qershor nga forcat serbe janë vrarë: Ajshe Kastrati (50), Haxhi Dobra (46), Luljeta Kastrati (24) dhe Xhevrie Shala (13). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Nën pushtetin e urdhrave*, 341-343; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 64-68; Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 173-183.

³⁷ Më 13 prill 1999, në fshatin Jabllanicë e Vogël janë vrarë Elfete Shala (23) dhe Sadik Shala (61) nga fshati Nakëll, ndërsa më 12 maj në fshatin Nakëll janë vrarë: Cucë Nikçi (58), Rexhep Nikçi (71) dhe Ali Cukaj (82). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 72-73; Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 207-210.

³⁸ Në fshatin Llabjan prej 3 deri më 9 maj, forcat serbe kanë vrarë këta persona: më 3 maj janë vrarë: Shaqir Lajçi (57), Halil Kelmendi (60), Arif Lajçi (61), Kapllan Lajçi (64), Isuf Kelmendi (65) dhe Zhuj Lajçi (101). Më 7 maj janë vrarë: Kreshnik Berisha (14), Besim Nikçi (28), Rifat Veseli (31), Muharrem Veseli (48), Musë Maloku (50) dhe Cenë Kelmendi (63). Më 8 maj është vrarë Bekim Kelmendi (28), ndërsa më 9 maj është vrarë Tahir Krasniqi (74). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 68-72; Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 221-225.

tjera përreth përjetuan sulmet e forcave serbe, por fatbardhësisht, përveç dëmeve materiale numri i vrasjeve dhe plagosjeve ishte më i vogël. Më 3 maj të vitit 1999, forcat serbe hynë në fshatin Ramun, ku përveçse dëbuan banorët nga fshati i tyre, ata njëkohësisht plaçkitën dhe dogjën shumë shtëpi të këtij fshati.³⁹ Në fillim të muajit prill 1999, forcat serbe sulmuan edhe fshatin Leshan. Edhe në këtë fshat u veprua njëjtë, banorët u maltretuan, plaçkitën, si dhe u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Një pjesë u deportuan në Mal të Zi e Shqipëri, ndërsa pjesa tjetër u strehuan nëpër male të fshatit Rusujë. Gjatë këtij sulmi shumë shtëpi u dogjën.⁴⁰ Dhunës, plaçkitjes, dëbimit nga shtëpitë si dhe djegies së shtëpive nuk u shpëtoi as fshati Kliçinë. Në këtë fshat shumë banorë janë plaçkitur e rrahur brutalisht, madje disa edhe janë plagosur. Në aksionin e forcave serbe ndaj fshatit Kliçinë më 29 mars të vitit 1999 është vrarë një fëmijë.⁴¹

Me krimet e forcave ushtarako-policore serbe në periudhën mars-qershor 1999 u përballën edhe fshatrat e Lugut të Trestenikut. Në këtë rajon, më 1 maj forca të shumta ushtarako-policore serbe sulmuan fshatin Nabërxhan. Gjatë këtij sulmi forcat serbe plaçkitën dhe dogjën shumë shtëpi, si dhe banorët i detyruan që të largohen nga fshati, forcat serbe prej 1 e deri më 10 maj, në fshatin Nabërxhan vranë 27 civilë shqiptarë.⁴² Krahas fshatit Nabërxhan, forcat serbe krimet e tyre i vazhduan edhe në fshatin

³⁹ Gjatë këtij aksioni të forcave serbe është plagosur rënd Besim Vrenezi (18), i cili në pamundësi që t'u mbijetoi plagëve, vdes. KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 75; Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 227.

⁴⁰ Më 7 qershor, në fshatin Leshan nga forcat serbe janë vrarë: Rukmane Sahiti (68) dhe Haxhi Sahiti (73). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 75; Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 227-228.

⁴¹ Më 29 mars është vrarë Gentrin Sheqeri (4), nga fshati Kliçinë. KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 127; Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë, 1998-1999*, Prishtinë 2012, 213; [më tej: Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve*]. Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 228.

⁴² Prej 1 deri më 10 maj në fshatin Nabërxhan janë vrarë këta persona. Më 1 maj janë vrarë: Shpëtim Kuçi (22), Bute Husaj (37), Vesel Ibërdemaj (40), Rexhep Kuçi (48), Isuf Dreshaj (49), Demë Kuçi (51), Sadik Ibërdemaj (52), Smajl Ibërdemaj (54), Xhemë Ibërdemaj (57), Ali Ibërdemaj (60), Ukë Lajçi (60), Zenel Ibërdemaj (62), Gjylë Bërbati (63), Shaban Ibërdemaj (65), Vesel Dreshaj (65), Ibish Muriqi (67), Haxhi Nikçi (70), Mic Shabanaj (70), Tushë Bërbati (70), Selman Ibërdemaj (75). Më 2 maj është vrarë Ramë Muriqi (68), më 10 maj janë vrarë: Hatixhe Berisha (44), Ibish Mujaj (52), Sulltane Lajçi (55), Bulake Mujaj (77), ndërsa më 12 maj është vrarë Metush Gashi (72). Më 7 maj në fshatin Ozdrim është vrarë Metë Husaj (39) nga Nabërxhani. KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 77-81.

Lutogllavë. Më 6 maj forcat ushtarako-policore serbe sulmojnë këtë fshat, ku si pasojë e këtyre sulmeve popullsia civile shqiptare tenton që të largohen nga fshati. Gjatë përpjekjeve për t'u larguar në drejtim të fshatit Trestenik, nga granatimet e forcave serbe vriten disa persona.⁴³ Kufomat e disa prej tyre akoma janë të zhdukur.

Forcat serbe gjatë muajve mars-qershor të vitit 1999, ushtruan dhunë si dhe kryen krime edhe ndaj popullsisë civile shqiptare në fshatin Katund i Ri, Vitomiricë, Ozdrim dhe Dubovë e Madhe. Dhuna ndaj popullsisë civile në Katund të Ri u intensifikua sidomos gjatë muajve maj dhe qershor të vitit 1999. Gjatë asaj kohe, forcat serbe në disa aksione të armatosura vranë, plaçkitën, burgosën si dhe dëbuan më dhunë banorët e këtij fshati. Më 11 maj 1999, forcat serbe hynë nëpër lagje të fshatit duke i detyruar banorët që të dalin nga shtëpitë e tyre dhe të tubohen në qendër të fshatit. Pas maltretimeve të shumta dhe pasi u plaçkitin vlera të mëdha të hollash, stoli nga ari, si dhe automjete, banorët i detyrojnë që përsëri të kthehen në shtëpitë e tyre, duke u thënë se duhet të jenë gati për të nesërmen në mëngjes, sepse do t'i dërgonin për në Shqipëri.⁴⁴ Aksioni i forcave serbe ndaj këtij fshati më 11 maj përfundoi edhe me vrasjen e disa civilëve. Të nesërmen më 12 maj, të njëjtët pjesëtarë të forcave serbe hynë në fshatin Katundi i Ri dhe me dhunë i detyrojnë banorët që të nisen në drejtim të qytetit të Pejës. Kolona e nisur në drejtim të Pejës ishte nën përcjelljen e vazhdueshme të forcave serbe, të cilët pas maltretimeve të shumta i dërgojnë deri në Gjakovë dhe prej andej përsëri i kthejnë në fshat. Fare pranë përfundimit të luftës, forcat serbe për tri ditë me radhë, më 4, 6 dhe 7 qershor të vitit 1999, hynë përsëri në fshatin Katund i Ri me ç' rast vranë dhe kryen një varg plaçkitjesh ndaj popullsisë civile të këtij fshati.⁴⁵ Sulmet e

⁴³ Gjatë sulmit të forcave serbe më 6 maj 1999 ndaj fshatit Lutogllavë vriten këta civilë: Rinor Kelmendi (1,5), Blerina Kelmendi (4), Bledar Kelmendi (8), Albulena Kelmendi (11), Avdi Kelmendi (30), Fatë Kelmendi (30), Bahrie Kelmendi (31), Sabri Kelmendi (39), Hatë Kelmendi (45), Sofë Kelmendi (65), Selime Kelmendi (74), Cane Ibrahim (75), Qerim Kelmendi (102). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 82-84.

⁴⁴ Deklaratë e Xhelal Bajraktari dhënë KMDLNJ-së, më 02.11.1999, në Pejë; Deklaratë e Demë Aliut dhënë KMDLNJ-së, më 20.03.2000, në Pejë; Deklaratë e Halil Veseli dhënë KMDLNJ-së, më 20.06.2000, në Pejë; Deklaratë e Shaban Sadikut dhënë KMDLNJ-së, më 08.02.2000, në Pejë; Deklaratë e Rexhep Ademajt dhënë KMDLNJ-së, më 20.06.2000, në Pejë; Deklaratë e Fatmire Sahitit dhënë KMDLNJ-së, më 20.06.2000, në Pejë.

⁴⁵ Në Katund të Ri më 11 maj janë vrarë: Xhevdet Bajraktari (40), Miradie Aliaj (47), Xhafer Grabovci (49) dhe Bardh Aliaj (58), ndërsa prej 4 deri më 14 qershor janë vrarë këta persona: më 4 qershor janë vrarë: Bajram Alushaj (44), Imer Ahmetaj (46), Ruke Tafilaj (60), Shaban Tafilaj (67), Sadik Tafilaj (70) dhe Ali Tafilaj (82). Më 6 qershor është vrarë Mehmet Zekaj (69) nga Jabllanica e Madhe, ndërsa më 7 qershor është vrarë

forcave serbe ndaj fshatit Vitomiricë filluan që nga 26 marsi.

Që nga ajo ditë e deri në përfundim të luftës, forcat serbe vazhdimisht kanë vrarë, rrëmbyer, maltretuar, rrahur, frikësuar e kërcënuar banorët e këtij fshati, e pastaj edhe ua kanë djegur shtëpitë.⁴⁶ Edhe në fshatin Ozdrim, gjatë aksionit të forcave serbe më 7 maj 1999, u veprua njëjtë, me plaçkitje, dëbim me dhunë nga shtëpitë, si dhe vrasje të civilëve⁴⁷, ndërsa më 13 prill forcat serbe ndërmarrin një aksion të armatosur ndaj fshatit Dubovë e Madhe. Edhe në këtë fshat popullsia civile është dëbuar, plaçkitur e deportuar me dhunë si dhe u janë plaçkitur dhe djegur shtëpitë.⁴⁸

Që në ditët e para pas ndërhyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë, forcat serbe sulmuan edhe fshatrat Novosellë, Radac, Jabllanicë e Madhe dhe Jabllanicë e Vogël. Në sulmet e forcave ushtarako-policore serbe ndaj fshatit Novosellë më 25 mars dhe 13 e 15 prill të vitit 1999, krahas dëbimeve, plaçkitjeve dhe djegieve të shtëpive, vriten edhe disa civilë. Në periudhën mars-qershor 1999, vriten edhe dhjetëra civilë të tjerë nga fshati Novosellë, qoftë gjatë sulmeve të forcave serbe ndaj këtij fshati apo gjatë deportimeve të tyre për në Mal të Zi.⁴⁹ Sulmet e forcave serbe ndaj fshatit

Havë Ahmetaj (75). Nga ky fshat më 11 prill është vrarë Gëzim Aliaj (27) në fshatin Jabllanicë e Vogël, më 10 maj është vrarë Bajram Sahitaj (86), ndërsa Gëzim Muçaj (14) është vrarë më 14 qershor në Fushë të Pejës. KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 85-87; Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës*, 117-122 .

⁴⁶ Nga fshati Vitomiricë në periudhën mars-qershor 1999, janë vrarë këta persona: Selim Isufaj (82) i vrarë më 27 mars, Qazim Zekaj (59) i vrarë më 13 prill, Zojë Shala (49) e vrarë më 28 prill. Më 3 maj është vrarë Faza Adriq (70), ndërsa më 12 maj janë vrarë: Dafina Ibraj (9), Gani Prelvukaj (50) dhe Beqir Prelvukaj (65), ndërsa më 12 qershor është vrarë Safet Liçina (44). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 87.

⁴⁷ Më 7 maj në sulmin e forcave serbe ndaj këtij fshati janë vrarë: Agron Gashi (18), Lumturije Zenunaj (19), Arlinda Krasniqi (20), Hasan Gashi (21), Muharrem Gashi (43), Ajshe Krasniqi (45), Esat Morina (45), Ramë Shala (45), Zymer Krasniqi (52), Shehrije Krasniqi (62), Isa Krasniqi (65), Zykë Shala (70), Rukë Krasniqi (75). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 90.

⁴⁸ Më 12 prill, në aksionin e forcave serbe të ndërmarrë ndaj këtij fshati janë vrarë: Tahir Spahia (52) dhe Ali Haxhiaj (62). Po në këtë ditë janë vrarë edhe Nifë Muzlijaj (65), Demë Gashi (73) dhe Hasan Muzlijaj (80), në fshatin Jabllanicë e Madhe të cilët ishin nisur drejt Malit të Zi. KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 89.

⁴⁹ Aksionet e forcave serbe ndaj fshatit Novosellë filluan më 25 mars. Që nga ajo ditë e deri më 24 maj në fshatin Novosellë janë vrarë këta civilë: më 25 mars është vrarë Qerim Sykaj (55), më 15 prill janë vrarë Gjyle Podrimçaku (71) dhe Sefer Ramaj (73), më 20 prill janë vrarë Smajl Thaçi (61), Mustafë Halitaj (65) dhe Musa Halitaj (67), ndërsa më 24 maj është vrarë Fatime Sylaj (77). Më 20 prill në fshatin Vitomiricë është vrarë Sylë Ahmetaj

Radac filluan më 28 mars 1999, për të vazhduar më 15 prill dhe 25 e 26 maj 1999. Në sulmet e forcave serbe ndaj fshatit Radac, janë vrarë disa civilë, ndërsa një numër i madh i popullsisë civile u dëbua me dhunë nga ky fshat.⁵⁰ Edhe popullsia civile e fshatrave Jabllanicë e Madhe⁵¹ dhe Jabllanicë e Vogël⁵², gjatë muajve mars-qershor 1999, është dëbuar me dhunë, plaçkitur, deportuar dhe vrarë.

Në pranverë të vitit 1999, aksionet e armatosura të forcave serbe vazhduan edhe ndaj fshatrave të Rugovës. Më 18 prill, forcat serbe sulmuan fshatrat e Rugovës, ku sulmet u ndërmorën nga tri drejtime: Qafa e Hajlës, nga drejtimi i Çakorrit dhe nga drejtimi i Pejës. Gjatë këtij sulmi në Rugovë përveç banorëve vendas ishin të strehuar edhe shumë banorë të fshatrave të Pejës e më gjerë. Të ndodhur përballë granatimeve të ashpra të forcave serbe, popullsia civile u detyrua që të largohet në drejtim të Malit të Zi. Prej 1 prillit 1999 deri në përfundim të luftës, forcat policore e ushtarake serbe, në aksione të shpërndara, në fshatra të Rugovës vranë dhjetëra civilë shqiptarë.⁵³ Edhe fshatrat e Lugut të Baranit gjatë vitit 1999 përjetuan dhunën e ushtruar nga forcat serbe. Edhe në këto fshatra që nga fillimi i ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, forcat serbe vranë në masë popullsinë

(81) nga Novosella. KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 92-93.

⁵⁰ Më 15 prill në aksionin e forcave serbe ndaj fshatit Radac janë vrarë këta civilë: Rasim Ahmetaj (37), Bajram Kurtaj (50), Muhamet Avdylaj (57), Shaban Ahmetaj (69), Ramadan Ahmetaj (67) dhe Fatime Shabanaj (70). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 92.

⁵¹ Më 3 maj, në Jabllanicë të Madhe, forcat serbe kanë vrarë këta civilë: Muhamet Muçaj (10), Florie Muçaj (16), Safete Muçaj (33), Havë Muçaj (48) dhe Isuf Muçaj (59). Më 20 maj është vrarë Sali Demaj (73), ndërsa më 22 maj janë vrarë: Zejnepe Zekaj (63), Shahë Zekaj (68) dhe Xhafer Zekaj (70). Më 26 mars në Pejë është vrarë Musa Zekaj (67). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 95.

⁵² Më 13 prill, forcat serbe sulmuan fshatin Jabllanicë e Vogël me ç'rast u vranë këta civilë: Idriz Shala (60), Muhamet Blakaj (60), Musë Rexhaj (65), Ahmet Rexhaj (65), Smajl Rexhaj (71) dhe Rexhep Mujaj (78). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 94.

⁵³ Në fshatrat e Rugovës në periudhën mars-qershor 1999 janë vrarë këta civilë: Më 1 prill është vrarë Bajram Qorraj (85), nga fshati Drelaj, më 25 prill është vrarë Vesel Nikçi (63), nga Reka e Allagës, më 27 prill është vrarë Metë Nikçin (50) nga Reka e Allagës. Më 1 maj në fshatin Drelaj forcat serbe kanë vrarë Jashar Lajçin (70) dhe Sykë Qorrajn (70), ndërsa Arianit Kastrati (11) nga Llazi, është vrarë më 1 qershor në Grykë të Rugovës. Më 27 mars, në fshatin Raushiq është vrarë Hasime Nikçi (55), nga fshati Shtupeq i Madh. KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 96-97; Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve*, 212; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 318.

civile. Aksionet ndaj fshatrave të Lugut të Baranit fillojnë që nga 26 marsi kur forcat serbe i detyrojnë me dhunë popullsinë civile në fshatin Çallapek që të largohen nga shtëpitë e tyre. Forcat serbe përsëri u kthyen në këtë fshat më 28 mars ku vranë disa civilë të cilët nuk kishin arritur që të largohen nga fshati.⁵⁴ Më 3 prill aksioni i forcave serbe vazhdoi në drejtim të fshatit Rashiq⁵⁵ dhe Kosuriq, gjatë të cilit u vranë disa civilë. Sulmet e njëpasnjëshme të forcave serbe ndaj fshatit Kosuriq si dhe vrasja e popullsisë civile vazhdoi edhe gjatë muajit maj.⁵⁶

Më 3 prill forcat serbe nga disa drejtime të ndryshme sulmojnë fshatrat Glllogjan, Nepole dhe Llugaxhi. Gjatë këtyre sulmeve një pjesë e popullsisë zhvendoset nëpër male, të cilët disa ditë pas këtij sulmi kthehen përsëri në shtëpitë e tyre, kurse pjesa tjetër shkon në drejtim të Shqipërisë.⁵⁷ Aksioni i forcave serbe ndaj fshatrave të Lugut të Baranit vazhdoi edhe më 4 prill, ku cak i sulmeve ishin fshatrat Breliq dhe Buçan. Gjatë këtij aksioni, forcat serbe pasi hynë në fshatin Broliç ndahen në dy drejtime dhe, pas plaçkitjes dhe djegies së shumë shtëpive të fshatit, vrasin dhe masakrojnë disa banorë të këtij fshati.⁵⁸ Ndërsa në fshatin Buçan, forcat serbe pasi sulmojnë këtë fshat i detyrojnë banorët me dhunë që të zhvendosën nga fshati, ku një grup banorësh të këtij fshati nisen në drejtim të Bjeshkëve të Lybeniqit, të cilët pas përfundimit të luftës janë gjetur të vrarë në këtë bjeshkë.⁵⁹ Gjatë aksioneve të forcave serbe ndaj

⁵⁴ Më 28 mars, forcat serbe në këtë fshat kanë vrarë: Rukë Berisha (55), Qazim Berisha (60), Shaban Berisha (63) dhe Ajshe Berisha (65). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 48; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 223.

⁵⁵ Më 3 prill në Rashiq janë vrarë: Sylë Bricori (60), Gjylë Shala (78), Tafë Shala (80) dhe Cyme Bricori (85). Më 5 prill janë vrarë: Nexhmedin Shala (33) dhe Gani Shala (44). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 49; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 251, 256.

⁵⁶ Më 21 maj në fshatin Kosuriq janë vrarë këta civilë: Isuf Maznikolli (47), Ryvë Kelmendi (65), Cymë Gashi (66) dhe Zymer Thaçi (81), ndërsa më 27 maj është vrarë Haxhi Kelmendi (90). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 50; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 230, 316.

⁵⁷ *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 46-47.

⁵⁸ Personat e vrarë më 4 prill në Breliq janë: Shake Gashi (38), Hysen Gashi (74) dhe Fanë Gashi (90). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 52; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 253.

⁵⁹ Më 7 prill në Bjeshkën e Lybeniqit janë vrarë këta persona nga fshati Buçan: Arif Gashi (13), Riza Gashi (20), Musa Gashi (23), Nexhat Gashi (25), Xhavit Gashi (41), Shaqir Gashi (55), Rustem Gashi (61) dhe Murat Gashi (67), ndërsa më 8 prill në Buçan janë vrarë Agron Gashi (17) dhe Kapllan Gashi (63). KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 52 ; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 258.

fshatrave të Lugut të Baranit, vrasje të civilëve u shënuan edhe në fshatrat: Glllogjan⁶⁰, Llugaxhi⁶¹, Kotrodiq⁶², Turjakë⁶³ dhe Rosujë.⁶⁴

Forcat ushtarako-policore serbe, gjatë muajve mars-qershor 1999, kryen krime edhe në fshatrat: Bllagaj⁶⁵, Ruhot⁶⁶, Jabllanicë e Leshanit⁶⁷, Loxhë,⁶⁸ Raushiq,⁶⁹ Zllapek.⁷⁰ Edhe pse numri i të vrarëve ishte më i vogël, megjithatë edhe në këto fshatra forcat serbe vepruan njëjtë, me dëbim të popullsisë civile, plaçkitje dhe djegie të shtëpive si dhe vrasje të civilëve.

Gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, vrasjeve, plagosjeve dhe formave tjera të dhunës iu nënshtuan edhe të burgosurit. Ndër krimet më të përgjakshme të kryera nga forcat serbe është vrasja dhe plagosja e qindra të burgosurve shqiptarë në burgun e Dubravës në maj të vitit 1999. Më 22 maj 1999, forcat serbe në bashkëpunim me të burgosurit serbë që ishin të

⁶⁰ Më 30 maj në fshatin Glllogjan është vrarë Fatë Berisha (60). KMDLNI, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 51; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 317.

⁶¹ Më 27 maj në Llugaxhi është vrarë Dedë Berisha (45). KMDLNI, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 51; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 316.

⁶² Më 6 prill, në këtë fshat janë vrarë: Shpëtim Thaçi (18) dhe Jeton Berisha (24). KMDLNI, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 48; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 256, 257.

⁶³ Në fshatin Turjakë është vrarë Serbeze Gashi (17), nga Barani i Ulët. KMDLNI, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 53; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 261.

⁶⁴ Më 3 prill në fshatin Rosujë është vrarë Riza Gashi (72). KMDLNI, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 53.

⁶⁵ Më 11 maj në fshatin Bllagajë është vrarë Mustafë Sadiku (80). KMDLNI, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 77; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 303.

⁶⁶ Më 5 maj të vitit 1999, në Ruhotë është vrarë Malë Kelmendi (75). KMDLNI, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 82; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 298.

⁶⁷ Më 3 prill, në fshatin Kosuriq është vrarë Hysen Atashi (72) nga Jabllanica e Leshanit. KMDLNI, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 76; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 251.

⁶⁸ Më 1 prill në fshatin Loxhë është vrarë Hysen Ademaj (39). KMDLNI, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 55.

⁶⁹ Nga ky fshat janë të vrarë: Ali Islamaj (58), i vrarë më 27 mars në Pejë dhe Sadik Krasniqi (75) i vrarë më 29 maj në Raushiq. KMDLNI, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 55; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 234.

⁷⁰ Në këtë fshat më 30 prill është vrarë Ramë Sefaj (17). KMDLNI, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 55; *Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 209.

burgosur në burgun e Dubravës, vranë, masakruan dhe plagosën të burgosurit shqiptarë. Krimi ndaj të burgosurve shqiptarë në burgun e Dubravës ishte planifikuar dhe përgatitur më parë. Rreth një muaj para se të ndodhte kjo masakër, të gjithë të burgosurit shqiptarë që ndodheshin nëpër burgjet e Serbisë, me vendim të Ministrisë së Drejtësisë të Serbisë ishin transferuar në burgun e Dubravës.⁷¹

Më 22 maj 1999, një ditë pas përfundimit të bombardimit të burgut nga forcat e NATO-s, forcat serbe në orët e hershme të mëngjesit, kishin urdhëruar të gjithë të burgosurit shqiptarë që të rreshtohen në fushën e sportit me arsyen se do t'i transferonin në burgun e Nishit. Mirëpo me të arritur në vendin e caktuar, forcat serbe shtien mbi ta duke vranë dhe plagosur shumë prej tyre. Ata të burgosur që i mbijetuan këtij sulmi u strehuan nëpër vende të ndryshme të burgut, aty ku mendonin se ishin më të sigurtë, duke u përkujdesur edhe për të burgosurit e plagosur.

Vrasja e të burgosurve kishte vazhduar edhe të nesërmen. Më 23 maj një grup gardianësh së bashku më të burgosurit serbë dhe me disa paraushtarakë, kontrollojnë vendet ku ishin strehuar të burgosurit e mbijetuar, e gjatë këtij kontrolli kudo që i hasën të burgosurit e strehuar i ekzekutojnë me armë zjarri, i therin me thika ose u hedhin bomba.⁷² Përsëri gjatë këtij sulmi vriten dhe plagosen një numër i madh i tyre. Pas vrasjes, forcat serbe kufomat e tyre i varrosin në një varrezë masive në fshatin Rakosh, jo shumë larg burgut të Dubravës. Ndërsa ata të burgosur që i mbijetuan kësaj masakre, më 24 maj 1999 transferohen në burgun e Lipjanit, ku qëndrojnë deri më 11 qershor të vitit 1999, e pastaj transferohen nëpër burgjet e Serbisë.⁷³ Në masakrën e burgut të Dubravës në mesin e të vranëve 13 persona janë nga komuna e Pejës.⁷⁴ Masakra në burgun e Dubravës është njëra ndër krimet më të rënda që Serbia nëpërmes forcave të saja të armatosura në Kosovë kreu ndaj të burgosurve politikë shqiptarë si dhe pengjeve të luftës. Përveçse në burgun e Dubravës, civilë të shumtë nga

⁷¹ Ramosaj, *Kundër harresës*, 198.

⁷² *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 101-108; *Krimet e luftës në Kosovë I*, 719-723; Martinsen, *Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 95-99; Ramosaj, *Kundër harresës*, 198.

⁷³ *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 104; *Krimet e luftës në Kosovë I*, 723.

⁷⁴ Në mesin e të vranëve në burgun e Dubravës, nga komuna e Pejës janë identifikuar këta persona: Artan Gjekaj (20) nga Zllapeku, Avni Gashi (25) nga Buqani, Nazmi Shala (26) nga Peja, Fadil Bezeraj (32) nga Rashiçi, Bedri Hasani (33), nga Peja, Osman Rastoder (35) nga Vitomirica, Nikollë Kolaj (44) nga Peja, Sahit Brahimaj (45) nga Kotradiaçi, Idriz Zhutaj (47) nga Raushiçi, Haki Dinaj (51) nga Raushiçi, Ali Kelmendi (55) nga Kusuriq, Iber Grabovci (58) Kusuriqi. Ukë Thaçi, *Masakra në burgun e Dubravës (skënarët e masakrës)*, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, Prishtinë 2011, 126-127; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 105-107; Martinsen, *Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 308, 311, 314.

komuna e Pejës janë vrarë edhe në fshatra të tjera të komunës së Istogut.⁷⁵ Vlen të përmendim faktin se një numër mjaft i madh i popullsisë civile nga komuna e Pejës janë vrarë edhe në komuna të tjera të Kosovës, si: Klinë⁷⁶, Deçan,⁷⁷ Gjakovë,⁷⁸ Junik,⁷⁹ Rahovec.⁸⁰ Gjithashtu civilë shqiptarë nga komuna e Pejës janë vrarë edhe në territorin e Malit të Zi, në fshatrat kufitare me Kosovën, gjatë deportimit për në këtë shtet.⁸¹ Përfundimi i luftës

⁷⁵ Në komunën e Istogut gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, janë vrarë këta persona: Ramë Gashi (74) nga Lutogllava i vrarë më 29 korrik 1998 në fshatin Shushicë, Xhevdet Gashi (46) është kidnapuar nga forcat serbe më 20 janar 1999 në Pejë dhe është gjetur i vrarë të nesërmen më 21 janar në fshatin Prekallë, Asllan Sefaj (16) dhe Azem Sefaj (63) nga Novosella janë vrarë më 13 prill 1999 në fshatin Kaliqan, më 14 prill në fshatin Orrobërdë është vrarë Zylë Durakaj (78), Kreshnik Husaj (15) nga Naberxhani është vrarë më 7 maj 1999 në Baicë. Më 8 maj 1999 në fshatin Saradran janë vrarë: Mustafë Dreshaj (45) dhe Berat Dreshaj (18) nga Fusha e Pejës; Rexhep Berisha (29) dhe Adem Rexhbogaj (62) nga Lutogllava; Remzi Shala (30), nga fshati Babiq, Gani Isufi (35) nga Sferka. KMDLNJ-*Buletini*, janar- mars 1999, 70; KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 24, 80, 93; Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë*, 112, *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 732, 735.

⁷⁶ Në komunën e Klinës janë vrarë këta persona: Milaim Gashi (32), dhe Nuredin Gashi (34) nga Kërstoci, janë vrarë më 29 mars 1999 në Poterq; Gjergj Krasniqi (34), nga fshati Nepole, është vrarë më 24 prill 1999 në fshatin Këpuz. KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 51, 56.

⁷⁷ Në komunën e Deçanit janë vrarë këta persona: Skënder Krasniqi (33) nga Barani, i vrarë më 27 prill 1998 në Dashinoc, Fazli Morina (30) nga Grabovci, i vrarë më 15 gusht 1998 në komunën e Deçanit, Vehbi Mustafa (62) nga Peja, i vrarë më 5 korrik 1998 në Deçan, Fuat Gashi (38) nga Peja, është vrarë më 30 mars 1999 në fshatin Strelc, Sadri Gashi (69) nga fshati Buqan, është vrarë më 10 prill 1999 në fshatin Maznik, Rexhep Gashi (72) nga fshati Breliq, më 10 prill 1999, është gjetur i vrarë në fshatin Dashinoc. OZLJPS- *Bilten*, april-jun, 1998, 123. KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 52; Osmani, *Krimet e Serbisë 1*, 70; Libër kujtimi i Kosovës, 258-259.

⁷⁸ Në komunën e Gjakovës janë vrarë këta persona: më 6 qershor 1998 në fshatin Zhabel është vrarë Qazim Krasniqi (38) nga Çallapeku. Hatixhe Gashi (26) dhe Fatime Gashi (55) nga Kosuriqi, janë vrarë më 6 prill 1999 në fshatin Bardhaniq. KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 50, 114.

⁷⁹ Në Junik, më 12 maj 1999 është vrarë Hamdi Neziri (43), nga fshati Babiq. KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 56.

⁸⁰ Në Rahovec më 20 korrik 1998 është vrarë Agim Qelaj (38), nga Peja. KMDLNJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; Osmani, *Krimet e Serbisë 1*, 65.

⁸¹ Në territorin e Malit të Zi më 18 prill 1999 janë vrarë këta civilë: Labinot Kastrati (13), nga Nabërgjani, Milazim Pelaj (39), Mursel Brahimaj (47), Rexhep Brahimaj (51), dhe Nemka Brahimaj (69) nga fshati Novosellë, janë vrarë në fshatin Husaj të Rozhajës, ndërsa në fshatin Bukel të Rozhajës më 18 prill janë vrarë Sokol Lajçi (14) nga fshati Pepaj dhe Tane Husaj (70) nga fshati Shkreli. Selim Kelmendi, nga fshati Qyshk më 25 prill 1999,

në Kosovë në qershor të vitit 1999 rezultoi me një numër të madh të personave të pagjetur. Gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, forcat serbe në komunën e Pejës përveçse vranë popullsinë civile shqiptare, një numër të konsiderueshëm të kufomave i zhvendosën nga vendet ku i kishin vlarë. Përveç kufomave, forcat serbe gjatë aksioneve të armatosura kishin marrë edhe civilë shqiptarë nga shtëpitë e tyre apo nga kolonat e të dëbuarve, për fatin e disa prej të cilëve akoma nuk dihet.⁸²

është vlarë nga forcat serbe në fshatin Husaj të Rozhajës. KMDL NJ, *Buletini*, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, 22-160; *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*, 93, 96; Teuta Shala-Peli, *Ditë e dhembjes krenare*, Kuvendi Komunal i Pejës, Prishtinë 2014, 126.

⁸² Në komunën e Pejës akoma nuk dihet për fatin e këtyre personave: Abedin Shala (19) i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Adem Lajqi (37) i zhdukur më 12 maj 1999 në Fushë të Pejës; Agim Gjocaj (42) i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Agim Selmanaj (47) i zhdukur më 14 maj 1999 në Pavlan; Ahmet Berisha (75), i zhdukur më 4 prill 1999 Pejë; Ahmet Krasniqi (33), i zhdukur më 15 gusht 1998 në Grabovc; Ajshe Krasniqi (45), e zhdukur më 7 maj 1999 në Ozdrim; Albulena Kelmendi (11), e zhdukur më 6 maj 1999 në Trestenik; Ali Alijaj (12), i zhdukur më 26 mars 1999 në Pejë; Arben Gjocaj (29), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Arben Kelmendi (21), i zhdukur më 5 prill 1999 në Kotradiq; Arif Shala (73), i zhdukur më 7 maj 1999 në Ozdrim, Arlinda Krasniqi (20), e zhdukur më 7 maj 1999 në Ozdrim, Artan Gashi (18), i zhdukur më 10 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Bahrie Kelmendi (31), e zhdukur më 6 maj 1999 në Trestenik; Binak Thaqi (80), i zhdukur më 28 prill 1999 në Jabllanicë; Bledar Kelmendi (8), i zhdukur më 6 maj 1999 në Trestenik; Bute Hysaj (35), e zhdukur më 2 maj 1999 në Nabergjan; Cenë Kelmendi (60), 1939 i zhdukur më 1 maj 1999 në Llabjan; Deli Bricori (36), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Demë Shala (44), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Dudie Osmanaj (60), e zhdukur më 31 mars 1999 në Pejë; Dykë Berisha (76), e zhdukur më 28 mars 1999 në Pejë; Emine Gashi (61), e zhdukur në prill 1999 në Pejë; Esmë Demaku (33), e zhdukur më 14 maj 1999 në Qyshk; Fatmir Alimehaj (18), i zhdukur më 7 prill 1999 në Lybeniq; Fatmir Osmanaj (35), i zhdukur më 31 mars 1999 në Pejë; Hajrie Dedushaj (90), e zhdukur më 6 maj 1999 në Lutogllavë; Haki Dinaj (51), i zhdukur më 16 maj 1999 në Dubravë; Halime Koçan (56), e zhdukur më 9 mars 1999 në Zllapek; Halit Dobra (31), i zhdukur më 14 maj 1999 në Zahaq; Hatë Alimehaj (72), e zhdukur më 7 prill 1999 në Lybeniq; Hatmane Alimehaj (43), e zhdukur më 7 prill 1999 në Lybeniq; Hazir Bezeraj (51), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Himë Ukaj (57), i zhdukur më 9 prill 1999 në Bellopoljë; Ibish Çeku (48), i zhdukur më 10 prill 1998 në Pejë; Ismet Ibraj (38), i zhdukur më 13 qershor 1999 në Pejë; Jahaja Nushi (70), i zhdukur më 18 maj 1999 në Pejë, Januz Bezeraj (60), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Jashar Hamzaj (64), i zhdukur më 1 prill 1999 në Lybeniq; Jeton Shala (28), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Kreshnik Berisha (14), i zhdukur më 1 maj 1999 në Llabjan; Kushtrim Shala (21), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Leonard Alimehaj (6), i zhdukur më 7 prill 1999 në Lybeniq; Lindita Prelvukaj (20), e zhdukur më 12 maj 1999 në Savino Voda; Lulzim Gjocaj (26), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Magribe Kajolli (28), e zhdukur më 17 qershor 1998 në Loxhë, Mehybe Shala (29), e zhdukur në maj 1999 në Doberdol; Muhamet Dobra (33), i zhdukur më 14 maj 1999

Gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, krimet që forcat policore e ushtarake serbe ushtruan, ndaj popullsisë civile në komunën e Pejës kishin si synim zhdukjen e familjeve të tëra, duke vrarë tre e më shumë anëtarë të së njëjtës familje, spastrimi etnik të cilin tentuan që ta realizonin me dëbimin e popullsisë civile shqiptare nga shtëpitë e tyre dhe deportimin e tyre për në Shqipëri dhe Mal të Zi, shkatërrimin e pronave dhe pasurisë nëpërmjet plaçkitjes, djegies dhe demolimit të shtëpive, si dhe plaçkitjen e civilëve shqiptarë, duke ua marrë me dhunë paratë, stollit, veturat si dhe gjërat e tjera më vlerë. Po ashtu vrasja e 520 civilëve, zhdukja pa gjurmë e 94 civilëve, si dhe plagosja e shumë të tjerëve, tregojnë qartë për gjenocidin e forcave serbe ndaj popullsisë civile në komunën e Pejës, gjatë luftës në Kosovë, 1998-1999. Nga 520 personat e vrarë nga forcat serbe në komunën

në Zahaq; Muhamet Gashi (27), i zhdukur më 6 prill 1999 në Lybeniq; Muhamet Kralani (64), i zhdukur më 3 prill 1999 në Pejë; Muhamet Neziraj (26), i zhdukur më 27 mars në Pejë; Muhamet Ukshinaj (2), i zhdukur më 7 prill 1999 në Lybeniq; Muharrem Bobi (61), i zhdukur më 1 prill në Lybeniq; Muharrem Veseli (49), i zhdukur më 1 maj 1999 në Llabjan; Muhmet Bezeraj (48), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Muradin Devolli (29), i zhdukur më 16 maj 1999 në Bjeshkët e Jabllanicës; Mustafë Idrizi (51), i zhdukur më 24 maj 1999 në Pejë; Naser Balaj (32), i zhdukur në maj 1999 në Pejë; Nazmi Gjocaj (44), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Nazmi Shala (43), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Osman Alimehaj (37), i zhdukur më 7 prill 1999 në Lybeniq; Qazim Radotina (86), i zhdukur më 2 prill 1999 në Pejë; Qerim Gashi (61), i zhdukur më 10 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Ragip Morina (62), i zhdukur më 29 mars 1999 në Beleg, Deçan; Ramiz Beqiri (75), i zhdukur më 10 qershor 1999 në Pejë; Ramiz Nallbani (36), i zhdukur në maj 1999 në Pejë; Razë Zymeraj (69), e zhdukur më 21 maj 1999 në Studenicë; Rinor Kelmendi (1,5), i zhdukur më 6 maj 1999 në Trestenik; Rukë Krasniqi (79), e zhdukur më 7 maj në Ozdrim; Ryvë Maznikolli (81), e zhdukur më 27 mars 1999 në Pejë; Ryvë Metaj (80), e zhdukur në maj 1999 në Kaliçan; Sali Rrustemaj (42), i zhdukur më 1 prill 1999 në Lybeniq; Sejdi Shala (34), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Selim Shala (41), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Selman Delijaj (31), i zhdukur më 20 dhjetor 1998 në Zahaq; Servete Gjocaj (27), e zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Smajl Huskaj (84), i zhdukur më 1 prill 1999 në Lybeniq; Smajl Jahmurataj (33), i zhdukur më 1 prill 1999 në Lybeniq; Smajo Qehaja (88), i zhdukur më 27 mars 1999 në Pejë; Sylë Gjocaj (23), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Shpend Hyseni (31), i zhdukur më 14 maj 1999 në Zahaq; Shqipe Osmanaj (35), e zhdukur më 31 mars 1999 në Pejë; Shyhrete Ukshini (30), i zhdukur më 7 prill 1999 në Lybeniq, Terezë Tunprenkaj (26), e zhdukur më 2 prill 1999 në Pejë; Valbona Krasniqi (17), e zhdukur më 6 shkurt 1999 në Turjakë; Valdet Berisha (26), i zhdukur më 28 mars 1999 në Kliqinë; Valdet Hetaj (23), i zhdukur më 28 mars 1999 në Vrellë; Valdet Shala (18), i zhdukur më 7 prill 1999 në Bjeshkët e Lybeniqit; Xhavit Berisha (35), i zhdukur më 10 prill 1999 në Lybeniq; Xhevat Krasniqi (24), i zhdukur më 6 shkurt 1999 në Turjakë; Zijadin Haxhijaj (47), i zhdukur më 14 prill 1999 në Kaliçan; Zymer Berisha (27), i zhdukur më 11 prill 1999 në Lybeniq; Zymer Krasniqi (52), i zhdukur më 7 maj 1999 në Ozdrim. ICRC, *Persons missing in relation to the events in Kosovo*, Fifth edition issued in April 2013, Pristina, 5-75.

e Pejës në periudhën mars 1998-qershor 1999, 437 janë të gjinisë mashkullore, 83 të gjinisë femërore si dhe 25 janë fëmijë prej 1,5 deri në 17 vjeç. Më 1998-1999 edhe komuna e Istogut u përballë me krimet e gjenocidit të ushtruar nga Serbia.

Forcat serbe edhe në këtë komunë përdorën forma të ndryshme të dhunës dhe terrorit ndaj popullsisë civile shqiptare. Që nga fillimi i vitit 1998, më saktësisht nga fundi i muajit janar në komunën e Istogut vërehet një shtim i madh i forcave ushtarake e policore serbe. Që nga fundi i janarit të vitit 1998, vërehej një mobilizim i forcave ushtarake serbe, të cilat kishin filluar që të bënin stërvitje ushtarake në fshatrat të Istogut rreth lagjeve dhe shtëpive të shqiptarëve,⁸³ duke ngjallur frikë tek popullsia civile e asaj zone.

Dhuna dhe provokimet ndaj popullsisë civile shqiptare në komunën e Istogut vazhduan edhe gjatë muajit shkurt. Persona të armatosur hynin në shtëpitë e shqiptarëve duke i maltretuar, plaçkitur dhe vrarë.⁸⁴ Në komunën e Istogut, veprimet e dhunshme të forcave serbe ndaj civilëve shqiptarë u intensifikuan sidomos pas fillimit të luftës në Kosovë. Më 14 mars të vitit 1998, forca të mëdha policore serbe fillojnë një aksion të armatosur në qytetin e Istogut. Që nga orët e hershme të mëngjesit e rrethojnë qytetin e Istogut dhe të gjitha rrugët lokale, pastaj fillojnë me të shtëna me armë zjarri si dhe me keqtrajtim fizik të qytetarëve në qendër të qytetit. Në këtë aksion të forcave serbe plagosen 15 persona.⁸⁵ Gjatë muajve prill, maj, qershor dhe korrik të vitit 1998, forcat serbe keqtrajtuan fizikisht si dhe plaçkitën banorët shqiptarë të kësaj komune.⁸⁶ Keqtrajtime ndaj civilëve shqiptarë u bënë sidomos në postblloqet ku ishin të pozicionuara forcat serbe në këtë komunë, si në postbllokun e Gjurakovcit dhe të Rakoshit. Po ashtu gjatë muajve prill-korrik të vitit 1998 nuk munguan as vrasjet dhe plagosjet e civilëve shqiptarë.⁸⁷ Forcat serbe vrasjen e parë në masë në komunën e

⁸³ *Krimet e luftës në Kosovë 1*, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, Prishtinë 2010, 728 (më tej: *Krimet e luftës në Kosovë 1*).

⁸⁴ Më 15 shkurt të vitit 1998 në Istog të Poshtëm, nga persona të armatosur është vrarë Aze Dekaj (71), dhe është plagosur bashkëshorti i saj. *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 728.

⁸⁵ *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 729.

⁸⁶ Më 31 maj të vitit 1998, policia serbe në Istog dhe në fshatrat Carrallukë, Kovragë, Rakosh dhe Zallq, kishin konfiskuar nga banorët e këtyre vendeve një autobusë, dy kamionë, dy kombi dhe një veturë. *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 730.

⁸⁷ Më 20 maj të vitit 1998, në fshatin Uçë të Istogut nga forcat serbe është vrarë dhe masakruar Bajram Aliaj (38) nga Shushica. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, *Buletini*, tetor-dhjetor, 1998, Viti VIII, nr. 9, 16 (më tej: KMDLNI - *Buletini*, tetor-dhjetor 1998); *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 730, 736, Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë, 1998-1999*, Libri 1, Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës, Prishtinë 2010, 370 (më tej: Osmani, *Krimet e Serbisë 1*); Fondi për të Drejtën Humanitare, Libër kujtimi i Kosovës 1998-2000, Prishtinë 2011, 179. (më tej: Libër kujtimi i Kosovës).

Istogut e kryen në fund të muajit gusht të vitit 1998, në familjen Salihaj nga fshati Shushicë e Poshtme e Istogut.

Më 29 gusht të vitit 1998, forca të mëdha policore kishin rrethuar lagjen “Salihaj” të fshatit Shushicë e Poshtme. Sulmi i tyre u shoqërua më të shtëna të shumta armësh, bastisje dhe djegie të shtëpive, veturave si dhe gjësendeve tjera me vlerë. Nga ky sulm i forcave serbe mbetën të vrarë nëntë persona, nga të cilët tetë anëtarë të familjes Salihaj.⁸⁸ Pas vrasjes së anëtarëve të familjes Salihaj, forcat serbe kishin tërhequr nga vendi i krimit kufomën e të vetmes femër të vrarë në këtë sulm, trupi i të cilës është gjetur më 9 nëntor të vitit 1998 në afërsi të postbllokut të policisë serbe në fshatin Rakosh të Istogut.⁸⁹ Gjendja e tensionuar si pasojë e dhunës së ushtruar nga forcat serbe, në komunën e Istogut vazhdoi edhe gjatë muajve në vijim.

Në fillim të muajit nëntor në Istog vërehet një përqendrim i madh i forcave policore, të cilët keqtrajtonin dhe merrnin në biseda informative kalimtarët e rastit.⁹⁰ Rrahje, bastisje të shtëpive me pretekst të kërkimit të armëve, si dhe maltretime tjera ndaj popullsisë civile shqiptare në komunën e Istogut, forcat serbe ushtruan edhe përgjatë muajit janar të vitit 1999.⁹¹ Po ashtu gjatë asaj kohe në të gjitha lokalitetet shihej një prani e madhe e forcave policore serbe.⁹² Prej datës 28 janar e deri më 24 mars të vitit 1999, forcat policore e ushtarake serbe, në aksione të shpërndara, në fshatra të komunës së Istogut vranë civilë shqiptarë. Më 28 janar të vitit 1999, një person i gjinisë mashkullore, nga fshati Llukafc i Begut është gjetur i vrarë në rrugën Gurrakoc-Klinë.⁹³ Edhe më 11 shkurt 1999, në afërsi të fshatit Zallç është gjetur i vrarë një person tjetër i gjinisë mashkullore nga Dubrava e Istogut.⁹⁴ Vrasja e civilëve shqiptarë dhe gjetja e tyre në lokalitete të

⁸⁸ Më 29 gusht të vitit 1998, nga forcat serbe u vranë këta anëtarë të familjes Salihaj: Hysni Salihaj (17), Arben Salihaj (19), Hysen Salihaj (21), Abedin Salihaj (28), Milaim Salihaj (36), Fatime Salihaj (46); Shaban Salihaj (49), Isa Salihaj (75), si dhe nipi i tyre Nazmi Gashi (22), nga Vojniku i Skënderajt. KMDLNJ - *Buletini*, tetor-dhjetor 1998, 13, 15, 25, 28; *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 718, 719, 738; Libër kujtimi i Kosovës, 181; Josef Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë? 1998-1999, Një dokumentim, 2013, 198. (më tej: Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?); Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve*, 193.

⁸⁹ KMDLNJ - *Buletini*, tetor-dhjetor 1998, 174.

⁹⁰ Po aty, 162.

⁹¹ Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, *Buletini*, janar- mars 1999, Viti IX, nr. 10, 68 (më tej: KMDLNJ - *Buletini*, janar- mars 1999).

⁹² Po aty, 53.

⁹³ Më 28 janar të vitit 1999, është vrarë Ali Visoçi (62) nga fshati Llukafc i Begut, ndërsa është gjetur i vrarë në lokalitetin Gurrakoc. KMDLNJ - *Buletini*, janar- mars 1999, 90; *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 716; Osmani, *Krimet e Serbisë 1*, 373.

⁹⁴ Më 11 shkurt të vitit 1999, në afërsi të fshatit Zallç është gjetur i vrarë Haki Hoti (30) nga Dubrava e Istogut. KMDLNJ - *Buletini*, janar-mars 1999, 100; *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 716.

ndryshme të Istogut vazhdoi edhe gjatë muajit mars.

Më 15 mars 1999, në fshatin Studenicë është gjetur trupi i pajetë i një personi,⁹⁵ ndërsa, më 17 mars 1999, përgjatë rrugës Gurrakoc-Istog, në afërsi të fshatit Tomoc, janë vrarë tre vëllezërit Dervishaj nga fshati Zabllaq i Istogut.⁹⁶ Nga fundi i muajit mars të vitit 1999, kohë e cila përkon me ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, gjendja në komunën e Istogut u rëndua gjithnjë e më shumë. Forca të shumta policore e ushtarake u mobilizuan e gjithashtu një mobilizim i madh u vërejt edhe në radhët e serbëve lokalë, të cilët u mobilizuan dhe u vendosën nëpër punkte të caktuara,⁹⁷ në komunën e Istogut. Po ashtu pas ndërhyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë, në komunën e Istogut vërehet një intensitet më i shtuar i dhunës së forcave serbe ndaj civilëve shqiptarë. Filloi vrasja masive e civilëve shqiptarë, dëbimi nga shtëpitë si dhe shkatërrimi i pronave të tyre. Mbrëmjen e 24 marsit të vitit 1999, në fshatin Lubozhdë, policia serbe sulmon familjen Meshi. Nga ky sulm në përleshje me forcat serbe mbesin të vrarë dy vëllezër nga kjo familje.⁹⁸

Dy ditë pas këtij sulmi, forcat serbe sulmojnë fshatin Padalishtë. Më 26 mars të vitit 1999, në mëngjes forcat ushtarake e policore serbe në bashkëpunim me serbët lokalë fillimisht kishin rrethuar fshatin Padalishtë, e më pastaj kishin hyrë në oborret e shtëpive të familjeve Imeraj. Nga ky sulm mbetën të vrarë 19 anëtarë të familjes së gjerë Imeraj, nga mosha 2 deri në 71 vjeç, si dhe u plagosën gjashtë anëtarë të tjerë të kësaj familjeje.⁹⁹ Pas

⁹⁵ Më 15 mars të vitit 1999, në Zabllaq të Istogut u gjetën trupat e pajetë të Rrahman Morinës (35) nga Baica e Istogut dhe Shaban Ramçajt (50) nga Studenica. KMDL NJ - *Buletini*, janar-mars 1999, 170.

⁹⁶ Më 16 mars të vitit 1999, përgjatë rrugës Gurrakoc-Istog, në afërsi të fshatit Tomoc, janë gjetur të vrarë vëllezërit Enver (16), Esat (20) dhe Ibrahim (33) Dervishaj nga Zabllaqi i Istogut. KMDL NJ - *Buletini*, janar-mars 1999, 171; Martinsen, *Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 210.

⁹⁷ *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 717.

⁹⁸ Mbrëmjen e 24 marsit të vitit 1999, në fshatin Lobožhdë, policia serbe sulmoi familjen Meshi. Nga ky sulm në përleshje me forcat policore serbe mbesin të vrarë vëllezërit Bashkim (33) dhe Afrim (37) Meshi. *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 717; Osmani, *Krimet e Serbisë 1*, 376; Martinsen, *Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 348.

⁹⁹ Më 26 mars të vitit 1999, nga forcat serbe u vranë këta anëtarë të familjes Imeraj: Afrim Imeraj (2), Arjeta Imeraj (11), Ardijana Imeraj (13), Xhyllfidane Imeraj (15), Violeta Imeraj (16), Florije Imeraj (18), Sebahate Imeraj (19), Feride Imeraj (20); Muhamet Imeraj (20); Nexhdet Imeraj (34); Rabe Imeraj (36); Fetije Imeraj (37), Hasan Imeraj (55), Bekë Imeraj (57), Mane Imeraj (67), Mihane Imeraj (67), Avdyl Imeraj (68), Rustem Imeraj (71), Shehide Imeraj (71). Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, *Buletini*, mars-shtator 1999, viti IX, Nr.11-12, 19, 26, 27, 29, 55, 57, 95, 117, 127, 133, 140, 151, 156 (më tej: KMDL NJ - *Buletini*, mars-shtator 1999); *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 724-727; Fetnete Ramosaj, *Kundër harresës, gjenocidi i Serbisë në Kosovë*

kryerjes së këtij krimi, forcat serbe kishin qëndruar nëpër rrugët e lagjes dhe të fshatit deri në mesditë duke u pamundësuar atyre që i kishin shpëtuar këtij krimi që t'u ofronin ndihmë të plagosurve. Pas tërheqjes së forcave serbe, të mbijetuarit e këtij krimi për disa ditë ishin strehuar disa në male e disa të tjerë në fshatrat afër, duke u munduar që t'u dalin në ndihmë personave të plagosur, pastaj pas disa ditëve ishin larguar për në Mal të Zi.¹⁰⁰ Në këtë krim ndaj familjes së gjerë Imeraj nga Padalishta e Istogut kanë marrë pjesë edhe serbët lokalë të fshatit Cerkolez të kësaj komune. Të mbijetuarit e këtij krimi në dëshmitë e tyre kishin përmendur me emra disa nga kryesit e këtij krimi.¹⁰¹

Vrasja në masë e familjes Imeraj më 26 mars të vitit 1999, ku nuk u kursyen as fëmijët, të moshuarit dhe femrat, dëshmon gjenocidin e forcave serbe ndaj civilëve shqiptarë në komunën e Istogut. Fatkeqësisht ky krim nuk ishte i vetmi në këtë komunë. Krimi ndaj familjes Imeraj shënon fillimin e krimeve dhe gjenocidit serb në komunën e Istogut pas ndërhyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë, ku popullsia civile shqiptare u përball si me vrasjet në masë ashtu edhe më ato individuale.¹⁰² Si rrjedhojë e kësaj dhune, forcat serbe në prill të vitit 1999 masakruan disa anëtarë të familjes së gjerë Lipaj nga fshati Kamenicë. Më 12 prill 1999 forcat ushtarake e policore serbe sulmuan fshatrat Vrellë dhe Studenicë.

Gjatë këtij sulmi popullsinë civile të këtyre fshatrave i detyruan të largohen në drejtim të maleve, të cilat janë në kufirin me Malin e Zi. Kishte edhe nga ata që gjatë deportimeve nga ana e forcave serbe nuk arritën që të largohen nga shtëpitë e tyre, apo nga lokalitetet përreth ku ishin strehuar. Ajo pjesë e popullsisë që nuk arriti të largohet, u përballën me dhunën e shtuar nga forcat serbe. Një pjesë e familjes Lipaj kishin arritur që nëpërmes bjeshkëve të largoheshin për në Mal të Zi, ndërsa një pjesë tjetër e familjes ishin zënë nga pjesëtarë të forcave serbe. Mëngjesin e 13 prillit të vitit 1999, forcat ushtarake e paraushtarake serbe, në fshatin Studenicë kishin vranë 11 persona,¹⁰³ 10 prej të cilëve ishin të familjes së gjerë Lipaj.

1998-1999, Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, Prishtinë 2017, 140. (më tej: Ramosaj, *Kundër harresës*); Martinsen, *Çfarë ndodhi në Kosovë?*, 223; Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve*, 193.

¹⁰⁰ *Krimet e luftës në Kosovë I*, 724-727.

¹⁰¹ Dëshmitarët e këtij krimi në dëshmitë e tyre, ndër personat që e kanë kryer këtë krim i përmendin edhe disa serbë të fshatit Cerkolez. *Krimet e luftës në Kosovë I*, 726.

¹⁰² Më 27 mars të vitit 1999, në Istog, nga forcat serbe është vranë Tahir Haxhijaj (62) nga Rakoshi, ndërsa më 29 mars të vitit 1999, forcat serbe kanë vranë në Gurrakoc Daut Bajramaj (65), nga po ky fshat. *Krimet e luftës në Kosovë I*, 737, 744.

¹⁰³ Më 13 prill të vitit 1999, në fshatin Studenicë të Istogut nga forcat serbe u vranë këta persona: Miridona Lipaj (13); Lindihane Lipaj (13), Njomëza Lipaj (14), Qëndresa Lipaj (15), Sabrije Lipaj (43), Hajrije Alijaj-Lipaj (62), Salë Lipaj (64), Nezir Lipaj (65);

Në mesin e të vrarëve ishin dy të moshuar dhe 9 femra, 4 prej të cilave ishin fëmijë. Për të humbur gjurmët e këtij krimi, forcat serbe 9 persona i kishin hedhur në pus, më pas pusin e kishin shkatërruar me eksploziv.¹⁰⁴ Krahas vrasjeve në masë, civilë të shumtë shqiptarë u vranë nga forcat serbe gjatë muajit prill të vitit 1999 në fshatrat Vrellë¹⁰⁵ dhe Kaliqan.¹⁰⁶ Gjatë muajve prill-maj të vitit 1999, vrasje të popullsisë civile shqiptare nga forcat serbe, por në numër më të vogël kishte edhe në fshatrat tjera të komunës së Istogut, si: Istog i Ulët,¹⁰⁷ Lubozhdë,¹⁰⁸ Dubovë e Vogël,¹⁰⁹ Shushicë,¹¹⁰ Cërcë,¹¹¹ Mojstir,¹¹² Studenicë,¹¹³ Orroberdë,¹¹⁴

Hatmane Mehaj (69), Fatime Rexhaj-Lipaj (74), Salih Zeqiraj (88). *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 723-724; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 262, 263; Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve*, 193.

¹⁰⁴ Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 68-69.

¹⁰⁵ Në fshatin Vrellë të komunës së Istogut gjatë muajit prill të vitit 1999, nga forcat serbe janë vrarë këta persona: Kimete Maraj (31) e vrarë më 1 prill 1999; Sadik Maxharraj (67) i vrarë më 2 prill 1999; Ahmet Maraj (61) dhe Binak Maraj (89) të vrarë më 12 prill 1999; Hake Mavraj (74), Hasan Blakaj (69) dhe Osman Rugova (69) të vrarë më 13 prill 1999; Begije Mujaj (80), Shaban Dreshaj (71), Sylë Dreshaj (85) dhe Xufe Dreshaj (80) të vrarë më 14 prill 1999; Shaban Maraj (81), i vrarë më 20 prill 1999; Emine Maxharraj (61) dhe Sheribane Maxharraj (33) të vrara më 22 prill 1999 dhe Fazli Maraj (74), i vrarë më 24 prill 1999, dhe Rabë Blakaj (89) e vrarë më 15 maj. KMDLNJ - *Buletini*, mars-shtator 1999, 36, 67, 85, 115, 117, 146; *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 736-744; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 261, 262, 348, 365.

¹⁰⁶ Në fshatin Kaliqan të komunës së Istogut gjatë muajit prill të vitit 1999 janë vrarë këta persona: më 10 prill 1999 është vrarë Beqir Ukaj (62), më 13 prill 1999 janë vrarë: Azem Mulaj (84) nga Orroberda, Brahim Kukleci (66) nga Llugat, Haxhi Osmanaj (73) nga Kaliqani, Hyrë Balaj (66) nga Cërca, Imer Rugova (69) nga Cërca, Isuf Mulaj (73) nga Orroberda, Kadri Rugova (71) nga Cerrca, Mihane Rugova (63) nga Cerrca, Shahe Gashi (48) nga Prigoda, Shkurte Gashi (76) nga Prigoda, Shkurte Rugova (74) nga Prigoda, Zizë Mehaj (89) nga Prigoda, Zojë Kukleci (66) nga Lluga. Më 14 prill 1999 janë vrarë: Haxhi Morina (73) nga Lubova, Ramë Ademaj (74) nga Lubova, Rexhep Ukaj (59) nga Baica, Sali Arifaj (77) nga Istogu i Ulët, ndërsa më 15 prill është vrarë Razë Thaqi-Loxha (76) nga Novosella. Në fshatin Kaliqan gjatë muajit maj janë vrarë dy persona, Fatime Rugova (96) nga Cerca, e vrarë më 12 maj 1999 dhe Arif Pepaj (79) nga Lubozhda, i vrarë më 20 maj 1999. KMDLNJ- *Buletini*, mars-shtator 1999, 38, 76, 120, 52; *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 736-745; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 230, 261, 262, 309, 348, 349, 352.

¹⁰⁷ Në prill të vitit 1999, në Istog të Ulët është vrarë Besarta Ferataj (16). Osmani, *Krimet e Serbisë 1*, 371; Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë, 1998-1999*, Prishtinë 2012, 193; [më tej: Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve*].

¹⁰⁸ Në prill të vitit 1999 në fshatin Lubozhdë nga forcat serbe vriten dy banorë të këtij fshati. Më 1 prill vritet Gani Pepaj (36), ndërsa më 4 prill vritet Arif Pepaj (63). *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 736, 738; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 250, 349.

¹⁰⁹ Më 12 prill të vitit 1999 në një sulm të forcave serbe në fshatin Dubovë e Vogël vriten këta persona: Atifete Kelmendi (27), Ismet Kelmendi (27), Xhevdet Kelmendi (33), Ramiz Kelmendi (61), Hajrije Demaj (61). *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 736, 737, 738, 741, 744.

Veriq,¹¹⁵ Dubravë,¹¹⁶ Muzhevinë,¹¹⁷ Kovragë,¹¹⁸ Baicë,¹¹⁹ Prigodë,¹²⁰ Serbobran,¹²¹ Lluga,¹²² Ozdrim,¹²³ Llukafci i Begut,¹²⁴ dhe Uçë.¹²⁵ Që nga fillimi i operacioneve ushtarake të NATO-s, forcat serbe në komunën e Istogut përveç vrasjeve, plagosjeve, përdorën edhe metodën e spastrimit

¹¹⁰ Në fshatin Shushicë më 4 prill të vitit 1999 nga forcat serbe janë vrarë: Bahtije Nimanaj (70), Selman Nimanaj (68), Fatmushe Sadikaj (71), Halil Sadikaj (66). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 736, 739, 739, 741, 744.

¹¹¹ Në fshatin Cërcë më 1 prill të vitit 1999, nga forcat serbe janë vrarë: Rifat Rexhaj (44), Shake Blakaj (44), Kadri Rexhaj (66), Zykë Rexhaj (72) dhe Isuf Rexhaj (72), ndërsa më 6 prill është vrarë Mehmet Brojaj (30). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 739-745; http://www.liberkujtimikosoves.org/db/kkp_sq/index.html; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 246, 256.

¹¹² Në fshatin Mojstir, më 6 prill të vitit 1999, nga forcat serbe janë vrarë: Rinas Musaj (5), Ganimete Ferataj (24) dhe Isuf Musaj (68). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 738, 740, 742; Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve*, 193.

¹¹³ Më 12 prill të vitit 1999, në fshatin Studenicë nga forcat serbe janë vrarë: Sadri Kuqaj (69), Rexhep Arifaj (68) dhe Havë Kuqaj (76). *KMDLNJ - Buletini*, mars-shtator 1999, 123; *Krimet e luftës në Kosovë I*, 739, 742.

¹¹⁴ Më 14 prill të vitit 1999 në fshatin Orrobërdë nga forcat serbe janë vrarë: Muhamet Muzlijaj (30) dhe Musë Nokshaj (62). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 740-741; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 262.

¹¹⁵ Më 14 prill të vitit 1999 në fshatin Veriq nga forcat serbe është vrarë Fetah Hajzeraj (66). *KMDLNJ - Buletini*, mars-shtator 1999, 123; *Krimet e luftës në Kosovë I*, 738, 743; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 251.

¹¹⁶ Më 4 prill të vitit 1999, në fshatin Dubravë nga forcat serbe janë vrarë: Rexhep Myrtaj (64) dhe Sofë Hysenaj (80). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 742-743.

¹¹⁷ Më 29 mars të vitit 1999, në fshatin Muzhevinë nga forcat serbe është vrarë Zejnije Ahmetaj (45), ndërsa më 13 prill të vitit 1999 është vrarë Zejnije Balaj (64). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 744.

¹¹⁸ Më 6 prill të vitit 1999, në fshatin Kovragë është vrarë nga forcat serbe, Besart Boletini (13). *KMDLNJ - Buletini*, mars-shtator 1999, 38; *Krimet e luftës në Kosovë I*, 737; Melihate Termkollli, *Loti i ngrirë në qepalla (Fëmijëria e pajetuar)*, Prishtinë 2012, 124; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 256; Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve*, 193.

¹¹⁹ Më 14 prill të vitit 1999, në fshatin Baicë, nga forcat serbe është vrarë Brahim Loxhaj (80). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 737; Osmani, *Krimet e Serbisë I*, 372.

¹²⁰ Më 14 prill të vitit 1999, në fshatin Prigodë, nga forcat serbe është vrarë Mustafë Mehaj (56). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 741; Osmani, *Krimet e Serbisë I*, 372.

¹²¹ Më 5 prill të vitit 1999, në fshatin Serbobran, nga forcat serbe është vrarë Hyle Shala (76). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 739; Osmani, *Krimet e Serbisë I*, 373.

¹²² Më 21 maj të vitit 1999, në fshatin Lluga, nga forcat serbe është vrarë Ali Balaj (81). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 736; Osmani, *Krimet e Serbisë I*, 370.

¹²³ Më 7 maj të vitit 1999, në fshatin Ozdrim, nga forcat serbe është vrarë Esat Morina (50). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 737; Osmani, *Krimet e Serbisë I*, 372.

¹²⁴ Më 12 maj të vitit 1999, në fshatin Llukafci i Begut, nga forcat serbe është vrarë Mustafë Blakaj (77). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 741; Osmani, *Krimet e Serbisë I*, 370.

¹²⁵ Më 7 maj të vitit 1999, në fshatin Uçë, nga forcat serbe është vrarë Sofë Hajzeraj (75). *Krimet e luftës në Kosovë I*, 743; 371.

etnik, duke e detyruar popullsinë civile shqiptare që të zhvendosen nga shtëpitë e tyre dhe të largohen jashtë Kosovës.

Në fund të muajit mars dhe fillim të prillit, filloi vala e madhe e deportimeve të popullsisë civile në këtë komunë. Mijëra shqiptarë etnikë të Istogut u dëbuan me forcë nga shtëpitë e tyre.¹²⁶ Fillimisht një pjesë u strehuan në fshatrat fqinje Trubuhoc dhe Saradran, ku ndiheshin përkohësisht më të sigurt, pastaj u detyruan të largohen jashtë Kosovës. Në fshatrat e përmendura më lart ishin tubuar rreth 50 000 persona të zhvendosur nga shtëpitë e tyre. Përveç banorëve të fshatrave të Istogut, aty ishin strehuar edhe banorët e dëbuar nga fshatrat e Pejës, Klinës, Deçanit, Gjakovës si dhe një numër i madh i banorëve nga rrethi i Mitrovicës.¹²⁷

Më 7 dhe 8 maj të vitit 1999, forcat serbe rrethojnë popullsinë civile të tubuar në fshatrat Trubuhoc dhe Saradran, duke i detyruar që të formojnë kolonën për t'i deportuar për në Shqipëri.¹²⁸ Deportimi i popullsisë civile nga kjo zonë u shoqërua me forma dhe metoda të ndryshme të dhunës dhe terrorit, si plaçkitje të parave, stolive dhe veturave, asgjësimin e dokumenteve të identifikimit, madje kishte raste kur gjatë deportimit, forcat serbe ndanin nga kolona meshkujt të cilët më pas i vrisnin.¹²⁹ Po ashtu, më 8 maj të vitit 1999 kur edhe ndodhi deportimi me dhunë i popullsisë civile të strehuar në fshatrat Trubuhoc dhe Saradran, forcat serbe vranë disa persona në fshatin Saradran, shumica prej të cilëve ishin nga ky fshat.¹³⁰ Po në këtë ditë, nga forcat serbe ishte vrarë edhe një person tjetër nga fshati Saradran, të cilit, forcat serbe pas vrasjes ia kishin djegur kufomën.¹³¹

¹²⁶ *Nën pushtetin e urdhrave. Krimet e luftës në Kosovë*, Human Rights Watch, Tiranë 2002, 257. (më tej: *Nën pushtetin e urdhrave*).

¹²⁷ *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës mars-qershor 1999*, KMDLNJ-së, Pejë 2002, 81-82. (më tej: *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës*).

¹²⁸ *Po aty*, 82.

¹²⁹ Më 8 maj të vitit 1999, forcat serbe në fshatin Carrabreg të Deçanit, ndajnë nga kolona e të dëbuarve e më pas i vrasin këta persona: Nexhmedin Nurqaj (24), Imer Nurqaj (34), Halil Nurqaj (34), Xhavit Nurqaj (39), Xhevat Shabanaj (39), Muharrem Turkaj (42), Arif Nurqaj (64), të gjithë nga fshati Kashic i Istogut. Po ashtu më 8 maj të vitit 1999, në fshatin Restovicë të Deçanit janë vrarë Hasan Dardallaj (1974) dhe Keç Dardallaj (1969) nga fshati Saradran. *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 736-744; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 301.

¹³⁰ Personat e vrarë janë: Nexhmedin Elshani (17), Bekim Mavraj (22), Muhajdin Elshani (22), Avdyl Elshani (37 Dinë Grabovci (54), të gjithë këta nga fshati Saradran. Pastaj Jeton Ahmetaj (25) nga Zabllaqi, Gani Isufi (35) nga Sferka e Pejës, si dhe Mustafë Dreshaj (45) dhe Remzi Shala (30) nga Peja. *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 735.

¹³¹ Më 13 shtator në fshatin Saradran, nën rrethojat e një shtëpie është gjetur kufoma e Ibish Mavraj (36) nga ky fshat, i vrarë dhe më pas i djegur nga forcat serbe më 5 maj të vitit 1999. *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 735, 742; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 301.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë, një numër i konsiderueshëm i popullsisë civile nga komuna e Istogut janë vrarë në komuna të tjera të Kosovës, si: Pejë,¹³² Klinë,¹³³ dhe Mitrovicë,¹³⁴ një pjesë e të cilëve kanë qenë të detyruar që të zhvendosen në ato fshatra apo lokalitete si pasojë e dhunës së ushtruar nga forcat serbe. Po ashtu ka raste kur banorë nga kjo komunë, gjatë deportimit për në Mal të Zi janë vrarë në territor të këtij shteti, përkatësisht në fshatrat kufitare me Kosovën.¹³⁵

Duke u mbështetur në të dhënat lidhur me vrasjen e popullsisë civile shqiptare nga forcat serbe në komunën e Istogut, mund të nxjerrim si konkluzion se gjatë periudhës janar 1998-12 qershor 1999, në komunën e Istogut janë evidentuar 145 civilë të vrarë nga forcat serbe.

Vetëm në periudhën mars-qershor 1999, janë vrarë 141 civilë. Mosha e të vrarëve sillet prej 2 deri në 96 vjeç. Nga 145 personat e vrarë, 89 janë të gjinisë mashkullore, 56 të gjinisë femërore si dhe 14 janë fëmijë. Gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, popullsia civile shqiptare në komunën e Istogut përveç vrasjeve u përball edhe me plagosje, deportime, shkatërrimin e vendbanimeve si dhe me plaçkitje të parave dhe objekteve tjera më vlerë, nga forcat serbe.

¹³² Në fshatra të komunës së Pejës janë vrarë këta persona: Xhafer Shatri (50) nga Istogu, i vrarë më 13 prill të vitit 1999 në Jabllanicë të Vogël, Murat Brahimaj (25) nga Kashica i vrarë më 14 prill të vitit 1999 në Jabllanicë të Vogël, Selim Brahimaj (54) nga Kashica, i vrarë më 14 prill të vitit 1999 në Radafc, Ibrahim Brahimaj (51) nga Kashica, i vrarë më 14 prill të vitit 1999 në Jabllanicë të Vogël, Cenë Ibrahimaj (78), nga Zallqi i vrarë më 6 maj të vitit 1999 në Lutogllavë, Fatë Kelmendi (30) nga fshati Drejë, e vrarë më 6 maj të vitit 1999 në Lutogllavë, Sofë Kelmendi (60) nga Rozhaja, e vrarë më 6 maj të vitit 1999 në Lutogllavë, Hasan Buleshkaj (56) nga Istogu i Ulët, i vrarë më 19 maj të vitit 1999 në Sejnovë-Jabllanicë e Madhe, Zizë Buleshkaj (66) nga Istogu i Ulët, e vrarë më 19 maj të vitit 1999 në Sejnovë-Jabllanicë e Madhe dhe Ramush Shatri (90) nga Tomoci, i vrarë më 24 maj të vitit 1999 në Jabllanicë të Pejës. *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 737-744; Martinsen, Çfarë ndodhi në Kosovë?, 262, 263, 299, 348.

¹³³ Në fshatra të komunës së Klinës janë vrarë këta persona: Rifat Blakaj (20) nga Trubohovci, i vrarë më 8 janar të vitit 1999 në Drenoc, Bardhec Ndrejaj (32) nga Gurakoci, i vrarë më 9 prill të vitit 1999 në Volljakë. *KMDLNI - Buletini*, janar-mars 1999, 47; *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 736, 742.

¹³⁴ Në fshatra të komunës së Mitrovicës janë vrarë këta persona: Tahir Jahaj (49) nga Rakoshi, i vrarë më 23 prill të vitit 1999 në Barbaniq, Fehmi Demiraj (32) nga Uça, i vrarë më 22 maj të vitit 1999 në Suhodoll, Isuf Haxhijaj (34) nga Rakoshi, i vrarë më 22 maj të vitit 1999 në Suhodoll, Nexhmedin Kajtazi (31) nga Uça, i vrarë më 22 maj të vitit 1999 në Suhodoll, Gani Ferataj (47) nga Uça, i vrarë më 25 maj të vitit 1999 në Suhodollë. *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 738-741.

¹³⁵ Arif Arifaj, (68), nga Istogu i Ulët, i vrarë më 23 maj 1999 në Fusha e Gilit-Rozhajë, *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 736.

Po ashtu 24 civilë akoma figurojnë në listat e personave të pagjetur.¹³⁶ Të gjitha këto janë dëshmi për gjenocidin që Serbia nëpërmes forcave të saja ushtarake e policore ka kryer në Kosovë gjatë periudhës së luftës 1998-1999.

¹³⁶ Në listën e personave të pagjetur figurojnë ende emrat e këtyre personave nga komuna e Istogut: Abedin Krasniqi (18), i zhdukur më 25 dhjetor 1998 në Istog; Sadri Ramqaj (32), i zhdukur më 17 tetor 1998 në Tiranë; Agon Keqaj (16), i zhdukur më 6 prill 1999 në Cërcë; Ajmane Ademaj (68), e zhdukur më 10 prill 1999 në Kaliçan; Bajram Dautaj (14), i zhdukur më 24 mars 1999 në Lubozhdë; Binak Dreshaj (61), i zhdukur më 13 prill 1999 në Vrellë; Bledar Kelmendi (8), i zhdukur më 6 maj 1999 në Trestenik; Enver Dervishaj (16), i zhdukur më 17 mars 1999 në Tomoc; Fran Berishaj (51), i zhdukur më 2 prill 1999 në Drejë; Gani Brojaj (33), i zhdukur më 6 prill 1999 në Cërcë; Hatmane Dreshaj (60), e zhdukur në prill të vitit 1999 në Studenicë; Haxhi Kajtazaj (54), i zhdukur më 4 prill 1999 në Istog; Hazir Hakaj (76), i zhdukur më 10 prill 1999 në Orrobërdë; Idriz Ukaj (66), i zhdukur më 14 maj 1999 në Kaliçan; Isuf Lubeniqi (51), i zhdukur më 8 maj 1999 në Staradran; Januz Gusturanaj (38), i zhdukur më 30 mars 1999 në Istog; Mehmet Maraj (40), i zhdukur më 1 prill 1999 në Vrellë; Qazim Gjikolli (18), i zhdukur më 28 mars 1999 në Vrellë; Sadik Ramqaj (69), i zhdukur më 20 maj 1999 në Studenicë; Sami Gashi (25), i zhdukur më 13 prill 1999 në Vrellë; Sefedin Gavranaj (16), i zhdukur më 6 prill 1999 në Cërcë; Sefer Mavraj (65), i zhdukur më 8 maj 1999 në Staradran, Shyhrete Hetaj (21), e zhdukur më 10 prill 1999 në Savina Voda; Zhukë Gashi (68), i zhdukur më 15 prill 1999 në Vrellë. *Krimet e luftës në Kosovë 1*, 747-748; Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve*, 194. ICRC, *Persons missing in relation to the events in Kosovo*, Fifth edition issued in April 2013, Pristina, 5-75.